



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:

“Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”

ofruar nga

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Eglantina Farruku


PhD. Eda Çela

Korrik / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT

Master Profesional në: “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Sociologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 675, datë 12.10.2018.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 214, datë 19.06.2023.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik / 2 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	60 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 PAE 8 / PAK 3 2023-2024 PAE 6 / PAK 5
18	Numri i studentëve:	14 studentë v.a. 2020-2021 10 studentë v.a. 2021-2022 13 studentë v.a. 2022-2023 11 studentë v.a. 2023-2024 0 studentë v.a. 2024-2025
19	Komente / të tjera:	-

 2

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të dytë “Master Profesional në Zgjidhjen e Konfliktëve me Ndërmjetësim”, ofrohet nga Departamenti i Sociologjisë në Universitetin e Tiranës dhe është miratuar me urdhër të Ministrit të Arsimit Nr. 675, datë 12.10.2018. Ky program përkon me një ngarkesë totale prej 60 kreditesh ECTS dhe shtrihet përgjatë një viti akademik, të organizuar në dy semestra.


Programi është konceptuar për t’iu përgjigjur mungesës së profilit të ndërmjetësimit dhe menaxhimit të konfliktëve në sistemin shqiptar të arsimit të lartë. Hartimi i tij është mbështetur mbi standarde dhe praktika të avancuara ndërkombëtare, duke marrë në konsideratë modele nga universitete të njohura ndërkombëtare si: *Columbia University* dhe *Nova Southeastern University* në SHBA, *University of Kent* në Britaninë e Madhe dhe *Philipps-Universität Marburg* në Gjermani.

Ky program synon formimin teorik dhe praktik të studentëve në fushën e analizës së konfliktëve, tipologjive të tyre, faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e tyre si dhe strategjive të ndërhyrjes për menaxhim dhe zgjidhje në mënyrë të strukturuar dhe të qëndrueshme. Një vëmendje e veçantë i kushtohet zhvillimit të kompetencave në ndërmjetësim si një formë alternative dhe paqësore e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Thelbi i programit është ndërtimi i kapaciteteve profesionale për të përballuar situata komplekse ndërpersonale dhe institucionale, duke nxitur ndërhyrje efektive në konflikte të natyrës sociale, kulturore, institucionale dhe komunitare. Përveç trajtimit teorik, studentët trajnohen në mënyrë praktike nëpërmjet simulimeve, rasteve studimore dhe praktikave profesionale, me qëllim zhvillimin e aftësive ndërpersonale dhe të komunikimit efektiv.

Diplomimi në këtë program u mundëson të diplomuarve të ndjekin procedurën ligjore për t’u licencuar si ndërmjetës në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 10 385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, me ndryshimet përkatëse (Ligji Nr. 81/2013 dhe Nr. 26/2018).

Gjithashtu, programi i shërben edhe profesionistëve të fushave të tjera që përballen me konflikte në përditshmërinë e punës së tyre – si mësues, punonjës socialë, oficerë sigurie në shkolla apo institucione të vuajtjes së dënimit, specialistë të Shërbimit të Provës, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe punonjës në administratën publike apo sektorin privat. Ndërtimi i aftësive të buta në ndërmjetësim dhe komunikim konstruktiv kontribuon ndjeshëm në përmirësimin e efikasitetit të tyre profesional.

 3

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u formua dhe u trajnua në përputhje me standardet dhe procedurat e përcaktuara nga ASCAL, me qëllim vlerësimin e programit të studimit Master Profesional në “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndermjetësim” të ofruar nga Departamenti i Sociologjisë, Fakulteti i Shkencave Sociale.

Procesi i vlerësimit përfshiu shqyrtimin e dokumentacionit të përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm dhe realizimin e vizitave në institucion më datë 27-28 Janar, 2025. Ekspertët e jashtëm të angazhuar në këtë proces ishin Dr. Eglantina Farruku dhe Dr. Eda Çela, të cilët u asistuan gjatë gjithë procedurës nga përfaqësuesja e ASCAL, Znj. Denisa Bogdani.

Gjatë procesit të vlerësimit, GVJ ka përdorur katër nivele për të vlerësuar përmbushjen e standardeve të programit të studimit: (1) standardet nuk përmbushen, (2) standardet përmbushen pjesërisht, (3) standardet përmbushen kryesisht, dhe (4) standardet përmbushen plotësisht. Vlerësimi është realizuar përmes takimeve të drejtpërdrejta me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Sociale, Drejtuesin e Departamentit të Sociologjisë, stafin akademik dhe studentët e këtij masteri, NJSBC, zyrën e këshillimit të karrierës, zyrën e burimeve njerëzore, zyrën e marrëdhënieve me jashtë, Erasmus+ dhe të projekteve, sekretarinë mësimore dhe bibliotekën.

Për realizimin e vlerësimit të përmbushjes së kritereve për akreditimin e programeve të studimit, GVJ ka mbështetur procesin në ligjet dhe aktet nënligjore për arsimin e lartë në Shqipëri, si dhe në informacionin e marrë nga takimet dhe dokumentacionin e ofruar nga institucionet. Gjatë vizitës, GVJ ka kërkuar dhe shqyrtuar dokumentacion shtesë për të pasur një pamje të plotë dhe të detajuar mbi performancën e programit të studimit.

Pas shqyrtimit të të gjitha të dhënave dhe informacionit të mbledhur, është hartuar një raport i vlerësimit të jashtëm, i cili është dërguar për shqyrtim nga institucionet përkatëse. Pas marrëdhënies së komenteve dhe sugjerimeve nga institucionet, raporti ka marrë formën e tij përfundimtare. Ky proces ka pasur si qëllim të ofrojë një vlerësim të paanshëm dhe objektiv të cilësisë së programit të studimit, duke ofruar gjithashtu rekomandime për përmirësimin e tij dhe rritjen e standardeve të arsimit të ofruar.


Universiteti i Tiranës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 25.06.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 22/23 Prot., datë 16.06.2025 dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 27.06.2025 dhe me shkresë zyrtare Nr. 1938/7 Prot., datë 08.07.2025, ardhur në protokollin e ASCAL më datë 08.07.2025.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft- Raportin, sqaron si më poshtë vijon:

1. Në lidhje me objeksionin dhe sqarimet për vlerësimin e standardit II.2, kriteri 1,

Në lidhje me konstatimin e bërë në draft-raportin e vlerësimit të jashtëm, sipas të cilit gjatë vitit akademik 2023–2024 Departamenti i Sociologjisë përbëhej nga vetëm 6 persona me status



personel akademik efektiv (PAE), në kundërshtim me pikën 4 të nenit 25 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, i cili kërkon që çdo departament të ketë të paktën 7 persona me këtë status, grupi i vlerësimit të jashtëm sqaron si më poshtë:

Në shkresën zyrtare nr. 164 prot., datë 20.06.2025, të dorëzuar nga Departamenti i Sociologjisë në kuadër të procesit të vlerësimit të jashtëm, është deklaruar se për vitin akademik 2023–2024 departamenti ka pasur në përbërje nëntë (9) persona me status PAE dhe tetëmbëdhjetë (18) persona me kontratë. Ky informacion është i konfirmuar në dokumentin 3.5/1 “Personeli efektiv PAE PAK – Tabela 1”, i cili është ngarkuar në sistemin elektronik dhe ku pasqyrohet qartë përbërja e plotë e personelit akademik për vitin në fjalë.

Gjithashtu, në të njëjtën shkresë, për vitin akademik 2022–2023, nga vetë departamenti është deklaruar se numri i PAE ka qenë 6, megjithatë, pas verifikimit të Tabelës 1 në dokumentin 3.5/1, rezulton se numri faktik i personelit akademik efektiv për atë vit ka qenë nëntë (9). Kjo diferencë vlerësohet të jetë rezultat i një gabimi teknik në procesin e raportimit, pasi lista emërore dhe numërimi i emrave të përfshirë në dokumentacionin zyrtar konfirmon përmbushjen e kërkesës ligjore për të dy vitet akademike të konsideruara.

Në këtë kuadër, grupi vlerësimit të jashtëm nënvizon se Departamenti i Sociologjisë ka përmbushur kriterin ligjor të përcaktuar në nenin 25 të Ligjit nr. 80/2015 në lidhje me minimumin e personelit akademik efektiv dhe se pasaktësitë e evidentuara janë të natyrës teknike dhe jo substanciale. Për sa më sipër **GVJ pranon komentin, raporti në këtë pikë ndryshon.**

2. Në lidhje me objeksionin dhe sqarimet për vlerësimin e standardit IV kriteri 1 dhe 2,

GVJ i qëndron mendimit të shprehur në raport duke vlerësuar se në raport dhe dokumentacionin shoqërues, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Për nevojat e tij, departamenti ka rekrutuar personel të ri akademik MSc, i cili aktualisht është në ndjekje të ciklit të tretë doktoratë. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

3. Në lidhje me objeksionin dhe sqarimet për vlerësimin e standardit IV, 3,

GVJ i qëndron mendimti të shprehur në raport, pasi standardi kërkon që të gjitha (jo vetëm disa ose pjesa më e madhe) syllabuseve të përditësohen me literaturën përkatëse. Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

4. Në lidhje me objeksionin dhe sqarimet për vlerësimin e standardit V 4,

GVJ i qëndron mendimit të shprehur në raport, pasi të dhënat në lidhje me cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve përgatiten dhe merren si produkte sasiore nga sekretaria mësimore dhe njësia bazë, nuk harton raporte analitike periodike në lidhje me profilin dhe cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të tyre. Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

5. Në lidhje me objeksionin dhe sqarimet për vlerësimin e standardit V 5,

GVJ i qëndron mendimit të shprehur në raport, pasi institucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument mbështetës, bazuar edhe në parimin e subsidiaritetit, se si studentëve iu garantohet përfshirja në

procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të këtij programi studimi konkret, duke reflektuar dhe sygjerimet apo kontributin e tyre. Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.



Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi MP “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” është në përputhje me interesat kombëtare, pasi ai kontribuon në zhvillimin e aftësive për zgjidhjen e konfliktëve dhe promovimin e paqes, një aspekt kyç për stabilitetin social dhe zhvillimin e shoqërisë shqiptare. Ky program ka potencialin të ndihmojë në forcimin e marrëdhënieve ndërmjet grupeve të ndryshme etnike dhe sociale, duke ruajtur paqen dhe harmoninë sociale. Për më tepër, ai ofron mundësi për të diplomuarit që të kontribuojnë në politikën dhe praktikën e administratës publike dhe organizatave ndërkombëtare, duke pasur një ndikim pozitiv në interesat kombëtare të shtetit. Programi i studimit Master Profesional në “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” i ofruar nga ky IAL, pasqyron vlerat kulturore dhe akademike kombëtare duke siguruar që përmbajtja e tij të reflektojë rëndësinë e traditave dhe praktikave të ndërmjetësimit në kontekstin shqiptar. Njohuritë dhe aftësitë që zhvillohen nga studentët janë në përputhje me vlerat etike dhe profesionale të shoqërisë shqiptare, duke mbajtur parasysh respektin për kulturën dhe identitetin kombëtar. <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 1.4. Strategjia-e-Zhvillimit-e-Universitetit-te-Tiranes-2023-2028</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.2 Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Sociologjisë</i> <i>Evidenca 1.26. Studimi-i-tregut-te-punes_UT 2022</i>



Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi është në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimet e institucionit të arsimit të lartë, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në formimin e profesionistëve të kualifikuar që do të luajnë një rol të rëndësishëm në fushën e zgjidhjes së konflikteve. Ky program është hartuar për të zhvilluar aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për studentët në kontekste të ndryshme sociale, politike dhe ndërkombëtare, duke u mundësuar atyre të përmbushin kërkesat e tregut të punës dhe nevojat e shoqërisë për zgjidhjen paqësore të konflikteve. Ky orientim është në përputhje të plotë me misionin e institucionit për ofrimin e arsimit cilësor dhe për kontribuimin në zhvillimin e aftësive që mbështesin stabilitetin dhe kohezionin social. Po ashtu, programi është i përshtatshëm për fushën e veprimtarisë, pasi ai ofron një balancë të kujdesshme ndërmjet teorisë dhe praktikës, të cilat janë të ngushtësisht të lidhura me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë, si dhe me kërkesat profesionale në fushën e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve. Programi ofron një qasje multidisiplinore, e cila përfshin aspekte të psikologjisë, të drejtësisë dhe menaxhimit të konflikteve, duke ofruar një bazë të fortë dhe gjithëpërfshirëse për studentët, që t'u mundësojë atyre të operojnë në një gamë të gjerë kontekstesh. Pavarësisht kësaj, është e rëndësishme që programi të zhvillohet dhe përditësohet për të mbetur relevant dhe efektiv përballë sfidave të vazhdueshme të fushës. <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 1.4. Strategjia-e-Zhvillimit-e-Universitetit-te-Tiranes-2023-2028</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.2 Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Sociologjisë</i> <i>Evidenca 1.26. Studimi-i-tregut-te-punes_UT 2022</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit	Programi i studimit “Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim” është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me strategjinë për zhvillim të Institucionit, Statutin dhe Rregulloren përkatëse, si dhe me fushat dhe drejtimet akademike të përcaktuara nga ky institucion. Ky program është një reflektim i strategjisë së zhvillimit të Institucionit, e cila ka si qëllim ofrimin e arsimit




dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	cilësor dhe promovimin e dijes në fusha që janë të rëndësishme për zhvillimin shoqëror dhe profesional të studentëve. Po ashtu, programi është i hartuar për të mbështetur objektivat e institucioneve akademike dhe për të kontribuar në krijimin e profesionistëve të kualifikuar në fushën e zgjidhjes së konflikteve, një fushë që është e lidhur ngushtësisht me nevojat e shoqërisë dhe kërkesat e tregut të punës. Në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Institucionit, programi respekton parimet e autonomisë akademike, transparencës dhe cilësisë së mësimdhënies, duke siguruar që ofrimi i tij të ndodhë brenda kuadrit të rregullave dhe politikave të përcaktuara. Ky program është gjithashtu në përputhje me orientimet akademike të Institucionit, duke mbështetur zhvillimin e aftësive praktike dhe teorike të studentëve. Në këtë kuadër, është e dukshme se programi i studimit është hartuar dhe implementuar në përputhje me strategjinë për zhvillim të Institucionit, Statutin dhe Rregulloren përkatëse, duke kontribuar kështu në përmbushjen e objektivave dhe angazhimeve të përcaktuara nga institucionet akademike. <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 1.4. Strategjia-e-Zhvillimit-e-Universitetit-te-Tiranes-2023-2028</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.2 Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Sociologjisë</i> <i>Evidenca 1.26. Studimi-i-tregut-te-punes_UT 2022</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit është hartuar dhe zhvilluar në përputhje të plotë me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit. Ky program përfshin elemente të rëndësishme që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm dhe promovimin e paqes, të cilat janë parime të konsoliduara në dokumentacionin strategjik kombëtar dhe ndërkombëtar. Programi është i lidhur ngushtë me nevojat e shoqërisë shqiptare për zgjidhjen e konflikteve dhe integrimin e praktikave moderne të menaxhimit të konflikteve në kontekste të ndryshme, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive të studentëve për të adresuar




	sfidat e paqes dhe stabilitetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në përputhje me dokumentacionin përkatës vendas, siç janë strategjitë kombëtare për zhvillim dhe dokumentet e politikave të arsimit, programi reflekton angazhimin për të përgatitur profesionistë që janë të aftë të kontribuojnë në ruajtjen e paqes dhe promovimin e stabilitetit social dhe politik. Po ashtu, programi është i përputhshëm me dokumentet ndërkombëtare, si Konventa për të Drejtat e Njeriut dhe Marrëveshjet e Bashkimit Evropian për zgjidhjen paqësore të konflikteve, duke integruar praktika dhe teoritë që janë të njohura dhe të pranura globalisht në fushën e ndërmjetësimit dhe menaxhimit të konflikteve. Në këtë mënyrë, programi “Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim” kontribuon drejtpërdrejt në përputhje me angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare për zhvillimin e shoqërisë dhe forcimin e kapaciteteve për zgjidhjen e konflikteve, duke reflektuar prirjet dhe kërkesat e zhvillimit global në këtë fushë. <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 1.4. Strategjia-e-Zhvillimit-e-Universitetit-te-Tiranes-2023-2028</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.2 Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Sociologjisë</i> <i>Evidenca 1.26. Studimi-i-tregut-te-punes_UT 2022</i> <i>Evidenca 4.5 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.5.1 Plani mësimor sipas modelit të tabelës 10</i> <i>Evidenca 4.5.2 Plani mësimor i programit të studimit i lidhur me personelin akademik (Tabela 12)</i> <i>Evidenca 4.5.3 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E (Tabela 9)</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master Profesional në "Zgjidhje të Konflikteve me Ndermjetësim", i ofruar nga Departamenti i Sociologjisë (Fakulteti i Shkencave Sociale), është në përputhje të plotë me parimet e përcaktuara në statutin, rregulloren e përgjithshme dhe strategjinë e institucionit.</i>

	Strategjia e institucionit ka përcaktuar qartë prioritetet e zhvillimit institucional dhe të programeve të studimit, me qëllim ofrimin e një diplome që të formojë profesionistë të kualifikuar, të pajisur me norma etike dhe profesionale, duke kontribuar në të njëjtën kohë në mbështetje të interesit kombëtar në fushën e arsimit dhe shkencës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	GVJ gjatë vizitës në institucion vuri re se ky IAL disponon përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e programit të studimit “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” në fushën akademike specifike. Pavarësisht se ky program është i ri, institucioni mbështet një histori të gjatë dhe të konsoliduar në fushat e arsimit dhe trajnimit profesional, duke siguruar një bazë të fortë për zhvillimin e këtij programi. Fakulteti i institucionit ka staf akademik të kualifikuar dhe me përvojë të pasur në fushën e menaxhimit të konfliktëve, ndërmjetësimit dhe fushave të lidhura, të cilët janë të aftë të ofrojnë një program cilësor dhe të bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare. Gjithashtu, institucioni ka burimet e nevojshme, përfshirë infrastrukturën akademike, teknologjinë dhe materialet e mësimdhënies, që mbështesin zhvillimin e një programi të tillë. Ky program përfiton nga qasja multidisiplinore e ofruar nga institucionet akademike përkatëse, si dhe nga mundësia për të krijuar lidhje me praktikantë dhe profesionistë të fushës, të cilët mund të kontribuojnë në zhvillimin dhe mbështetjen e programit. Për më tepër, institucioni ka zhvilluar mekanizma të mbështetjes për studentët, siç janë këshillimi akademik dhe mundësitë për praktika profesionale, të cilat sigurojnë një përvojë të pasur dhe të plotë për studentët. Në këtë mënyrë, institucioni ka krijuar një ambient të favorshëm për ofrimin e programit “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”, i cili është mbështetur nga

	përvoja dhe kapacitetet e tij akademike, dhe është i gatshëm të ofrojë një përvojë cilësore dhe të qëndrueshme për studentët e tij <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.4. Strategjia-e-Zhvillimit-e-Universitetit-te-Tiranes-2023-2028</i> <i>Evidenca 3.5 (1) Personeli efektiv PAE PAK Tabela 1</i> <i>Evidenca 4.5 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.5.2 Plani mësimor i programit të studimit i lidhur me personelin akademik (Tabela 12)</i> <i>Evidenca Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit (Tabela 6)</i> <i>Evidenca 4.13 Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik (Tabela 7)</i> <i>Evidenca 4.15 CV e personelit akademik dhe ndihmës akademik për programin e studimit</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” është hartuar në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse për ofrimin e tij, duke siguruar që si fusha e përgjithshme ashtu edhe ajo specifike të jenë koherente me klasifikimin dhe kodifikimin e programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe evropiane. Programi është i integruar në një strukturë akademike që respekton kategoritë dhe kriteret e përcaktuara për këtë fushë, duke i dhënë mundësi studentëve të zhvillojnë një kuptim të thelluar teorik dhe praktik për menaxhimin e konfliktëve dhe ndërmjetësimin në nivele të ndryshme. Në këtë kuadër, programi është i përputhshëm me kërkesat dhe klasifikimin e programeve të studimit në nivel kombëtar dhe evropian, duke siguruar se është zhvilluar në përputhje me standartet dhe udhëzimet përkatëse të arsimit të lartë. Struktura e tij ofron një kombinim të balancuar midis teorisë dhe praktikës, që është në përputhje me orientimet e zhvillimit të fushave akademike dhe kërkimore, duke garantuar një nivel të lartë të cilësisë dhe koherencës me fushat e studimit dhe hulumtimit të njësisë përgjegjëse. Ky program, gjithashtu, mbështetet në kërkime dhe studime të avancuara, duke siguruar një lidhje të fortë midis teorisë akademike dhe praktikës në fushën e ndërmjetësimit dhe menaxhimit të konfliktëve. <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i>

	<i>Evidenca 1.4. Strategjia-e-Zhvillimit-e-Universitetit-te-Tiranes-2023-2028</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.2 Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Sociologjisë</i> <i>Evidenca 4.5 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.5.3 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E (Tabela 9)</i> <i>Evidenca 3.11 Strategjia e kërkimit shkencor për DS 2020-2024</i> <i>Evidenca 3.12 Vendim i DS për miratimin e prioritetëve të kërkimit shkencor</i> <i>Evidenca 2.14. Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave</i> <i>Evidenca 1.24. Strategjia institucionale per mesimdhenien 2022-2027 vendim-nr.24.</i> <i>Evidenca 1.24. Strategjia institucionale per mesimdhenien 2022-2027 vendim-nr.24.pdf</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i ciklit të dytë “Master Profesional në Zgjidhjen e Konfliktëve me Ndërmjetësim” është projektuar dhe ofrohet nga Departamenti i Sociologjisë, në kuadër të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, duke u pozicionuar qartësisht brenda fushës së shkencave sociale, në përputhje me profilin, misionin dhe objektivat strategjike të këtij fakulteti. Ky program është konceptuar për të plotësuar boshllëkun ekzistues në ofertën akademike shqiptare në fushën e menaxhimit të konfliktëve dhe ndërmjetësimit, duke u mbështetur në modele dhe standarde të avancuara ndërkombëtare. Programi synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike dhe aftësi praktike në analizën, menaxhimin dhe zgjidhjen e konfliktëve, duke pasur në thelb zhvillimin e kompetencave profesionale për ndërmjetësimin dhe ndërhyrjen efektive në situata të ndryshme sociale, institucionale dhe komunitare. Përmes një kombinimi të disiplinave të ndryshme si sociologjia, psikologjia, e drejta, komunikimi dhe menaxhimi, ky program mbarb një qasje të qartë ndërdisiplinore, duke i mundësuar studentëve të kuptojnë dhe të trajtojnë konfliktet nga këndvështrime të ndryshme shkencore dhe profesionale.




	Në këtë mënyrë, programi jo vetëm që është i integruar natyrshëm në portofolin akademik të Fakultetit të Shkencave Sociale, por edhe shërben si një urë lidhëse ndërmjet fushave të ndryshme të shkencave humane dhe sociale, duke përgatitur profesionistë të aftë për të vepruar në një gamë të gjerë kontekstesh dhe rolesh në tregun e punës. <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.5 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	NA
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe takimet në institucion me studentët e programit të studimit Master Profesional në “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”, GVJ konstatoi se institucioni ka demonstruar angazhimin e tij për ofrimin e trajnimeve profesionale të mëtijshme për studentët, duke bashkëpunuar ngushtësisht me punëdhënësit dhe aktorët relevantë të tregut të punës. Programi i “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” ka ndërtuar lidhje të mira me institucione, organizata dhe profesionistë të fushës së menaxhimit të konfliktëve dhe ndërmjetësimit, duke mundësuar që studentët të kenë mundësi për t’u angazhuar në trajnime profesionale edhe pas diplomimit. Këto trajnimet janë të përqendruara në zhvillimin e aftësive praktike dhe të avancuara, të cilat janë të nevojshme për t’u përballur me kërkesat e ndryshme të profesionit dhe për t’u përshtatur me ndryshimet e vazhdueshme në fushën e zgjidhjes së konfliktëve dhe ndërmjetësimit. Përmes këtij bashkëpunimi, institucionet dhe punëdhënësit sigurojnë që trajnimi të jetë i fokusuar dhe i adaptuar në përputhje me nevojat dhe prioritetet e tregut të punës, duke mundësuar që diplomantët të kenë mundësi për zhvillim të mëtijshëm profesional dhe karrierë të suksesshme. Programi gjithashtu ofron mundësi për ndihmesë në krijimin e rrjeteve profesionale dhe zhvillimin e mundësive të punësimit për studentët e




	diplomuar, përmes mundësive për praktikë dhe angazhimit në projekte konkrete me punëdhënës dhe organizata të fushës. Ky bashkëpunim me punëdhënësit është një garanci për cilësinë e trajnimeve dhe përgatitjen e studentëve për sfidat profesionale, duke siguruar që ata të jenë të aftë për t'u integruar me sukses në tregun e punës pas diplomimit. Po ashtu, Universiteti ka krijuar Qendrën Virtuale të Trajnimit dhe Zhvillimit Profesional, e cila ofron mundësi të vazhdueshme për trajnime dhe zhvillim profesional për studentët, ish-studentët dhe stafin akademik. Kjo platformë kontribuon në mbështetje të rritjes profesionale dhe përgatitjes së vazhdueshme të të gjithë grupeve të interesuara, duke siguruar mundësi për përmirësimin e aftësive dhe njohurive në fusha të ndryshme. <i>Evidenca 1.20. Vendim SA për ngritjen e qendrës virtuale të trajnimit dhe zhvillimit profesional</i> <i>Evidenca 4.23 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese</i>			
Konkluzione	Në përfundim, GVJ vlerëson se Departamenti i Sociologjisë ka kapacitetet dhe burimet e nevojshme për të ofruar programin e studimit në "Zgjidhjen e Konfliktëve me Ndërmjetësim" në përputhje me kërkesat akademike të fushës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së	Institucioni ka krijuar një strukturë të qartë dhe efikase për hartimin, mbikëqyrjen dhe menaxhimin e programit "Zgjidhja e Konfliktëve me Ndërmjetësim", duke siguruar bashkëpunim të frytshëm brenda institucionit. Ndarja e detyrave mes njësisë dhe personelit është e strukturuar dhe e përcaktuar në mënyrë të qartë, e cila mundëson menaxhimin efikas të çdo faze të zhvillimit dhe ofrimit të programit. Kjo qartësi e përgjegjësive garanton që çdo

detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	anëtar i stafit të ketë një rol të përcaktuar dhe të kontribuojë në monitorimin dhe ofrimin e programit. Për më tepër, institucioni ka implementuar mekanizma të rregullt për analizën e punës së stafit akademik dhe administrativ, për të siguruar që programi të zhvillohet në përputhje me standardet akademike dhe kërkesat e tregut. Ky proces përfshin mbikëqyrje të vazhdueshme dhe vlerësime periodike të performancës së programit, duke u siguruar që përmbajtja dhe metodat e mësimdhënies të jenë të përditësuara dhe të përshtatshme për zhvillimet e fushës dhe nevojat e studentëve. Analiza e vazhdueshme e punës së njësive dhe stafit nxit përmirësim të vazhdueshëm dhe siguron që programi të mbetet relevant dhe i efektshëm. Në këtë mënyrë, institucioni garanton një menaxhim të suksesshëm dhe efikas të programit, duke krijuar një ambient të përshtatshëm për zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve, si dhe duke mbështetur bashkëpunimin e suksesshëm brenda institucionit. <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës-2022</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 2.5. Struktura organizative e FSHS 2024</i> <i>Evidenca 2.6. Struktura e programeve të studimit të FSHS për të tre ciklet e studimit</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.5 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.5.2 Plani mësimor i programit të studimit i lidhur me personelin akademik (Tabela 12)</i> <i>Evidenca 4.14 Ngarkesa totale e personelit akademik (Tabela 13)</i> <i>Evidenca 4.9 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit (Tabela 6)</i> <i>Evidenca 3.7 Raporti vjetor e Departamentit të Sociologjisë 2022-2023/2023-2024</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca 3.8 Formulari tip i raportimit të veprimtarive kërkimore</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të	Institucioni ka krijuar dhe implementuar marrëdhënie bashkëpunimi të qëndrueshme dhe efikase me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorë të ndryshëm

studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	të biznesit, për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve të programit “Zgjidhja e Konfliktëve me Ndërmjetësim”. Këto marrëdhënie janë të fokusuar në zhvillimin e aftësive praktike të studentëve dhe ofrimin e mundësive për trajnime dhe praktika profesionale. Bashkëpunimi me institucione akademike, si brenda ashtu dhe jashtë vendit, mundëson shkëmbimin e praktikave më të mira dhe ofron mundësi për studentët të angazhohen në aktivitete ndërkombëtare, duke pasuruar kështu përvojën e tyre profesionale. Për më tepër, bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendës dhe të huaj krijon një lidhje të ngushtë me tregun e punës dhe kërkesat praktike të profesionit. Ky angazhim ka mundësuar integrimin e aspekteve të kërkesave të industrisë dhe praktikave profesionale në program, duke siguruar që studentët të jenë të përgatitur për të përballuar sfidat dhe kërkesat e fushës së zgjidhjes së konfliktëve dhe ndërmjetësimit. Ky partneritet i ngushtë mes institucioneve akademike dhe aktorëve të biznesit është një garanci për cilësinë e procesit mësimor dhe realizimin e objektivave të programit në formimin dhe zhvillimin e studentëve. Në këtë mënyrë, marrëdhëniet e bashkëpunimit janë të strukturuar për të mbështetur një proces mësimor të integruar dhe multidimensional, që siguron përgatitjen e studentëve për sfidat e tregut të punës dhe i ndihmon ata të arrijnë nivele të larta të aftësive profesionale dhe akademike. <i>Evidenca 4.23.1 Marrëveshje bashkëpunimi Fondacioni Zgjidhja e Konfliktëve</i> <i>Evidenca 4.23.2 Marrëveshje bashkëpunimi Dhoma kombëtare e Ndërmjetësve</i> <i>Evidenca 4.23.3 Marrëveshje bashkëpunimi me Odën e Ndërmjetësuesve Kosovë</i> <i>Evidenca 4.23 4.23 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese</i> <i>Evidenca 3.7 Raporti vjetor e Departamentit të Sociologjisë 2022-2023/2023-2024</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të	Departamenti i Sociologjisë ka krijuar dhe implementuar marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani dhe aktorë të fushës, për realizimin e praktikave profesionale dhe mundësive të tjera për studentët. Këto marrëveshje janë të fokusuar në mundësimin e praktikave profesionale dhe stazheve, që janë të integruara në program dhe

fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	ofrojnë studentëve eksperiencë praktike dhe zhvillim të aftësive në terren. Bashkëpunimi me punëdhënësit siguron mbikëqyrje dhe realizim të praktikave profesionale në përputhje me standardet më të larta, duke ndihmuar studentët të integrohen më lehtë në tregun e punës. Për më tepër, bashkëpunimi me aktorët e fushës për realizimin e kërkimeve shkencore avancuese kontribuon në zhvillimin e metodave të reja dhe njohurive në zgjidhjen e konflikteve. Marrëveshjet dhe bashkëpunimet gjithashtu mbështesin mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve, duke mundësuar shkëmbimin e përvojave dhe mundësi ndërkombëtare studimi. Këto marrëveshje janë thelbësore për cilësinë dhe zhvillimin profesional të studentëve. <i>Evidenca 4.24 Raport analitik nga përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe nga takimi me grupet e interesit, GVJ konstatoi se anëtarët e Fakultetit të Shkencave Sociale janë aktivisht të angazhuar në marrëveshjet e bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit. Departamenti i Sociologjisë ka implementuar një praktikë të rregullt për hartimin e raporteve analitike që vlerësojnë dhe monitorojnë përfitimet nga këto marrëveshje për programin Master Profesional "Zgjidhja e Konflikteve me Ndërmjetësim". Raportet ofrojnë informacion mbi mundësitë për praktika profesionale, kërkime shkencore dhe zhvillimin e aftësive praktike, duke siguruar përputhshmëri me objektivat e programit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ky proces analizues kontribuon në optimizimin e bashkëpunimeve dhe garanton që ato të jenë të dobishme për studentët dhe programin. <i>Evidenca 3.7 Raporti vjetor e Departamentit të Sociologjisë 2022-2023/2023-2024</i> <i>Evidenca 4.24 Raport analitik nga përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i>
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se programi i studimit MP "Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim" ka lidhur një serë marrëveshje bashkëpunimi me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat, duke pasur parasysh numrin e kufizuar të studentëve, ofrojnë mundësi të mjaftueshme për realizimin e komponentit praktik të programit, duke siguruar cilësi dhe efikasitet në zhvillimin e aftësive praktike të studentëve.</i>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Pas shqyrtimit të strukturës së programit të studimit MP "Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim" dhe të përputhshmërisë së tij me legjislacionin vendas dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), programi plotëson kërkesat për akreditim në këtë aspekt. Struktura e programit është në përputhje të plotë me rregulloret dhe aktet ligjore të arsimit të lartë në nivel kombëtar, duke përfshirë kërkesat për kredite dhe aktivitete formuese të caktuara nga autoritetet përkatëse. Programi ka përdorur në mënyrë të saktë Sistemin e Krediteve ECTS për matjen e ngarkesës së punës së studentëve, ku secili modul dhe aktivitet formues është i përcaktuar qartë në terma kreditesh, duke siguruar që studentët të kenë mundësi për të ndjekur një plan të strukturuar të studimit dhe për të arritur një balancë të duhur të ngarkesës akademike. Aktivitetet formuese janë të ndryshme dhe të balancuara, duke përfshirë leksione, seminare, aktivitete praktike dhe mundësi për internship në fushën e ndërmjetësimit. Kjo ndihmon në zhvillimin e aftësive të studentëve në zgjidhjen e konfliktëve dhe përgatitjen e tyre për profesionin. Mënyrat e vlerësimit janë të përcaktuara qartë dhe përfshijnë provime, punë praktike dhe projekte të lidhura me situata reale të zgjidhjes

	së konflikteve, duke siguruar që studentët të mund të demonstrojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre praktike në mënyrë të vlerësueshme dhe të drejtë. <i>Evidenca 4.5 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.5.3 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E (Tabela 9)</i> <i>Evidenca 4.14 Ngarkesa dotale (Tabela 13)</i> <i>Evidenca 4.19 Format e kontrollit të njohurive</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i> <i>Evidenca 4.3 Rrregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.16 Model i diplomës</i> <i>Evidenca 4.17 Model suplementi i diplomës</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit MP “Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim” synon zhvillimin e njohurive të avancuara dhe aftësive profesionale për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në këtë fushë. Ai ofron mundësi për formimin e shprehive të veçanta në një gamë të gjerë profesionale dhe specialitetesh, duke përfshirë një kuptim kritik të teorive dhe parimeve akademike. Programi ndihmon studentët të zhvillojnë njohuri dhe aftësi të thelluara, të cilat janë të nevojshme për zgjidhjen e sfidave në situata të ndryshme profesionale dhe akademike, duke i përgatitur ata për të adresuar dhe menaxhuar konflikte në mënyrë efektive dhe kreative. <i>Evidenca 4.5 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.5.3 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E (Tabela 9)</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i> <i>Evidenca 4.3 Rrregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit “Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim” ka përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe për detyrimet përmbyllëse. Kjo ngarkesë është tërësisht e përputhshme me kërkesat e Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), duke siguruar që studentët të kenë mundësi të zhvillojnë praktika të lidhura ngushtë me profesionin dhe të përfundojnë detyrimet përmbyllëse që vlerësojnë njohuritë dhe

	aftësitë e fituara gjatë programit. Kjo strukturë mundëson që studenti të fitojë eksperiencë të drejtpërdrejtë profesionale dhe të realizojë një projekt përfundimtar që tregon aftësitë e tij në zgjidhjen e konflikteve dhe ndërmjetësimin. Sipas planit mësimor të programit të studimit janë të përcaktuara kreditet për praktikën profesionale (6 ECTS) si dhe kreditet për detyrimet përmbyllëse (12 ECTS). <i>Evidenca 4.5 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.5.3 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E (Tabela 9)</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i> <i>Evidenca 4.3 Rrregulloret e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.7 Manual i praktikës profesionale</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	N / A
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të	N / A

kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Programi i ciklit të dytë “Master Profesional në Zgjidhjen e Konfliktëve me Ndërmjetësim” ofrohet nga Departamenti i Sociologjisë, pjesë e Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës, një institucion publik i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Ky institucion funksionon në përputhje të plotë me legjislacionin kombëtar për arsimin e lartë, konkretisht Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe nuk gëzon status të veçantë apo të diferencuar nga institucionet e tjera të arsimit të lartë në vend. Të gjitha procedurat e administrimit, organizimit, drejtimit dhe sigurimit të cilësisë për këtë program zbatohen sipas standardeve dhe rregulloreve të përgjithshme të aplikuara për institucionet publike të arsimit të lartë në Shqipëri. Kjo garanton që programi të jetë i integruar brenda sistemit të unifikuar të arsimit të lartë, pa privilegie apo trajtim të veçantë ligjor ose institucional.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit MP në “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”, i ofruar nga Departamenti i Sociologjisë, përbën programin e vetëm të këtij lloji në Republikën e Shqipërisë. Për këtë arsye, ky kriter nuk mund të evidentohet për krahasim me programe të tjera të ngjashme brenda vendit.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi “Master Profesional në Zgjidhjen e Konfliktëve me Ndërmjetësim” është kodifikuar sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, duke përdorur kodin përkatës të programit në përputhje me fushën dhe nivelin e studimit. Sa i përket kodifikimit të lëndëve, institucioni ka ndjekur procedurën zyrtare dhe ka depozituar pranë Ministrisë propozimet për kodifikimin individual të lëndëve të këtij programi, në përputhje me udhëzimet dhe afatet e përcaktuara nga aktet nënligjore në fuqi. Megjithatë, në momentin e hartimit të këtij raporti, institucioni nuk ka marrë ende përgjigje zyrtare nga autoritetet përkatëse për kodet individuale të lëndëve. Për pasojë, në planin mësimor aktual, lëndët janë të listuara vetëm

	me emrat, ngarkesën, kreditet dhe semestrin përkatës, por pa kode të veçanta identifikuese. Institucioni mbetet në pritje të miratimit zyrtar të kodifikimit të lëndëve, në mënyrë që të plotësojë në mënyrë të plotë kërkesat ligjore dhe administrative për transparencë, menaxhim akademik dhe përputhshmëri me standardet e arsimit të lartë në Shqipëri.			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Sociologjisë i Fakultetit të Shkencave Sociale.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se programi i studimit ofrohet në përputhje me kriteret dhe kërkesat ligjore, si përsa i përket organizimit të programit, ndarjes në ECTS, ashtu edhe për kriteret e pranimit. Kjo siguron një strukturë të qartë dhe të disiplinuar të programit, duke mundësuar që ai të përmbushë standardet akademike dhe ligjore të kërkuara. Për më tepër, përputhshmëria me këto kritere garanton cilësinë dhe integritetin e programit, duke siguruar një përgatitje të qëndrueshme dhe të mirëstrukturuar për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin	Organet drejtuese dhe autoritetet përgjegjëse të Fakultetit të Shkencave Sociale, së bashku me njësitë e tij përbërëse, informohen rregullisht mbi aktet ligjore, nenligjore dhe rregulloret e reja të miratuara, duke u siguruar që ato të zbatohen në mënyrë të plotë dhe të saktë nga strukturat përkatëse. Në

në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

përputhje me Rregulloren e Fakultetit, përgjegjësi i Departamentit të Sociologjisë luan një rol kyç në drejtimin dhe koordinimin e procesit të hartimit të kurrikulave për të gjitha ciklet e studimit, duke pasur në qendër nevojat akademike dhe kërkesat e tregut të punës.

Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Programi i studimit ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri", dhe VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë" ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021.


Fakulteti i Shkencave Sociale, përbëhet nga 5 njësi bazë:

1. Departamenti i Sociologjisë;
2. Departamenti i Shkencave Politike;
3. Departamenti i Punës dhe Politikave Sociale;
4. Departamenti i Pedagogji Psikologjisë;
5. Departamenti i Filozofisë;

Departamenti i Sociologjisë është njësia bazë përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zhvillimin e programit të studimit Master Profesional në "Zgjidhjen e Konflikteve me Ndërmjetësim", duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse ndaj procesit akademik, administrativ dhe financiar. Përveç sigurimit të cilësisë së mësimdhënies dhe përmbajtjes akademike, departamenti monitoron dhe vlerëson ecurinë e programit përmes vendimmarrjes kolegjiale, duke u angazhuar në përmirësime të vazhdueshme.

Referuar dok 3.5 (1) *Personeli efektiv PAE PAK Tabela 1*, të dhënat e departamentit për dy vite akademike janë si më poshtë:

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr.	1	2	1	2
Prof. Asoc.	4	2	4	2



	Dr./PhD.	2	10	2	10
	Msc.	2	4	2	4
	Totali	9	18	9	18
	<i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 2.5. Struktura organizative e FSHS 2024</i> <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.13 Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik Tabela 7</i> <i>Evidenca 2.6.1. Struktura mësimore përgjatë një viti akademik 2023-2024, 2024-2025</i> <i>Evidenca 2.13 Rregullore e Njesisë së Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë në FSHS</i> <i>Evidenca 3.5 (1) Personeli efektiv PAE PAK Tabela 1</i>				
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi duke angazhuar personel të kualifikuar ndihmës akademik dhe administrativ për realizimin e praktikave mësimore. Ky angazhim siguron që procesi mësimor të jetë i mbështetur nga staf i trajnuar dhe i përgatitur mirë për të ofruar udhëzime të sakta dhe mbështetje për studentët gjatë aktiviteteve praktike. Personeli ndihmës është i përfshirë në organizimin dhe mbikëqyrjen e praktikave, duke garantuar që çdo aktivitet të zhvillohet sipas standardeve të kërkuara dhe në përputhje me rregulloret akademike dhe ligjore të institucioneve të arsimit të lartë. Kjo strukturë mbështet një përvojë mësimore cilësore dhe të plotë për studentët, duke i përgatitur ata për sfidat profesionale në fushën e zgjidhjes së konfliktëve dhe ndërmjetësimit. <i>Evidenca 4.23 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese</i> <i>Evidenca 4.23.1 Marrëveshje bashkëpunimi Fondacioni Zgjidhja e Konfliktëve</i> <i>Evidenca 4.23.2 Marrëveshje bashkëpunimi Dhoma kombëtare e Ndërmjetësve</i> <i>Evidenca 4.23.3 Marrëveshje bashkëpunimi me Odën e Ndërmjetësuesve Kosovë</i> <i>Evidenca 4.23.4 Marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Tiranë</i> <i>Evidenca 4.23.5 Marrëveshje bashkëpunimi me Universita' di Siena</i>				





	<i>Evidenca 4.23.6 Marrëveshje bashkëpunimi me Shërbimin e Provës</i> <i>Evidenca 4.5 Plan i miratuar mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.7 Manual i praktikës profesionale</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit “Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim” cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e ecurisë dhe zhvillimin e programit, si dhe për realizimin e praktikave profesionale në përputhje me objektivat e programit. Koordinatori i programit siguron që aktivitetet mësimore dhe praktikat profesionale të zhvillohen në përputhje me kërkesat akademike dhe profesionale, duke monitoruar përmbushjen e standardeve dhe duke mbajtur lidhje të ngushta me stafin akademik dhe administrativ. Ky rol është thelbësor për sigurimin e cilësisë dhe rritjen e efikasitetit të programit, si dhe për mbështetje të vazhdueshme për studentët gjatë gjithë procesit të studimit. <i>Evidenca 4.3 Rrregullore e Programit të Studimit</i>			
Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe i të dhënave të mbledhura gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, rezulton se Departamenti i Sociologjisë, si njësia bazë përgjegjëse për programin “Master Profesional në Zgjidhjen e Konflikteve me Ndërmjetësim”, ka respektuar dispozitat ligjore në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike të programit. Programi është miratuar me urdhër të Ministrit të Arsimit, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore përkatëse.</i> <i>Njësia bazë ka caktuar koordinatorin e programit, i cili mbikëqyr realizimin e planit mësimor dhe bashkëpunon me strukturat ndihmëse akademike dhe administrative për organizimin e praktikave mësimore, mbështetjen e studentëve dhe menaxhimin e proceseve akademike. Gjithashtu, janë të angazhuar edhe personel ndihmës dhe administrativ, të cilët kontribuojnë në realizimin e praktikave dhe funksionimin e përditshëm të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Programi i studimit “Master Profesional në Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” është organizuar në mënyrë koherente dhe të integruar, duke u shtrirë në një vit akademik me 60 kredite ECTS të ndara në dy semestra. Struktura e programit është konceptuar për të ofruar një progresion logjik të njohurive dhe kompetencave, duke filluar me bazat teorike dhe duke avancuar drejt aplikimeve praktike. Në semestrin e parë (30 ECTS), programi fokusohet në ndërtimin e bazës teorike dhe konceptuale me lëndë si “Tipologji të konfliktëve bashkëkohore”, “Konfliktet shoqërore dhe kultura shqiptare”, “Aspekte ligjore të ndërmjetësimit”, “Psikologji konflikti”, “Komunikimi dhe etika profesionale”, “Drejtësia restauruese”, “Analiza e konfliktit” dhe “Teori dhe praktika të ndërmjetësimit”. Këto lëndë sigurojnë një kuptim të thellë të natyrës së konfliktëve dhe bazave teorike të ndërmjetësimit. Semestri i dytë (30 ECTS) përqendrohet në zhvillimin e kompetencave të avancuara dhe aplikimin praktik të njohurive, duke përfshirë lëndë si “Metoda alternative të zgjidhjes së konfliktëve: Negocimi dhe Arbitrazhi”, “Strukturat sociale të konfliktëve dhe paqes”, një lëndë me zgjedhje (“Ekstremizmi i dhunshëm” ose “Sociologji ligji”), praktikën profesionale (6 ECTS) dhe punimin e diplomës/provimin e formimit (12 ECTS). Kjo strukturë siguron që studentët të përvetësojnë fillimisht bazat teorike dhe metodologjike të fushës, për t'i aplikuar më pas këto njohuri në kontekste praktike përmes praktikës profesionale dhe punimit përfundimtar. Organizimi i përmbajtjes së programit reflekton qartë objektivat e tij për të përgatitur profesionistë të aftë në fushën e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konfliktëve, duke kombinuar në mënyrë efektive dimensionet teorike, praktike dhe etike të kësaj fushe. <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 4.3 Rrregullore e Programit të Studimit</i>



	<i>Evidenca 4.5 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Master Profesional në “Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim” është i strukturuar sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020, i ndryshuar (Kreu IV B, pika 3) dhe VKM nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar. Ky program përmban një plan mësimor të detajuar, i cili përfshin ndarjen e lëndëve në semestre, ngarkesën mësimore të moduleve, si dhe shpërndarjen e orëve mësimore në auditor dhe jashtë auditorit. Programi është i organizuar në dy semestra, me një total prej 60 kreditesh, duke ofruar një balancë të kujdesshme midis përmbajtjes teorike dhe aktiviteteve praktike. Në semestrin e parë zhvillohen tetë lëndë, secila me ngarkesën përkatëse të shprehur në orë dhe kredite, me një total prej 30 kreditesh. Në tërësi, numri vjetor i orëve mësimore arrin në 1500 orë, të cilat janë të shpërndara në leksione, seminare, praktika profesionale dhe orë studimi individual. Ky organizim i qartë dhe i strukturuar i programit mundëson një menaxhim efektiv të ngarkesës akademike, duke siguruar një përvojë të plotë mësimore për studentët. Gjithashtu, programi garanton transparencë dhe qasje të lehtë ndaj informacionit për studentët dhe stafin akademik, duke krijuar kushte optimale për realizimin e suksesshëm të objektivave akademike dhe profesionale. <i>Evidenca 4.5 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.5.3 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E (Tabela 9)</i> <i>Evidenca 4.14 Ngarkesa dotale (Tabela 13)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	GVJ konstaton se rregullorja e Programit të studimit në MP “Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim” përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Ky informacion është i qartë dhe i aksesueshëm për të siguruar që studentët të kuptojnë plotësisht kërkesat për t'u pranuar në program, mundësitë e transferimit të krediteve nga/tek institucione të tjera, si dhe procedurat për ekuivalentimin e studimeve të kryera jashtë institucioneve të arsimit të lartë. Kjo transparencë garanton një proces të drejtë dhe të standardizuar për studentët që duan të hyjnë në program ose të kalojnë nëpër faza të ndryshme të studimeve.

	<i>Evidenca 4.3 Rrregullore e Programit të Studimit</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë, përfshirë praktikën, seminarët, dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Këto syllabuse janë të detajuara dhe përmbajnë përshkrime të qarta të objektivave të lëndëve, aktiviteteve të mësimdhënies, materialeve të nevojshme dhe metodave të vlerësimit. Programi siguron që çdo komponent formues, përfshirë orët e punës praktike dhe seminarët, të realizohet në përputhje me formatet e miratuara dhe të standardizuara, duke mundësuar një mësimdhënie efektive dhe një përvojë mësimore të balancuar për studentët. <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i> <i>Evidenca 4.7 Manual i praktikës profesionale</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Përmbajtja e programit të studimit “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” është subjekt i përmirësimit dhe përditësimit të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik, bëhen miratimet e ndryshimeve eventuale dhe përditësimeve që mund të nevojiten për të përmirësuar cilësinë dhe përshtatshmërinë e programit. Të gjitha ndryshimet e miratuara dokumentohen dhe arkivohen në një dosje të plotë për të siguruar transparencë dhe përputhshmëri. Kjo mundëson që informacioni të jetë i aksesueshëm për studentët, stafin akademik dhe administrativ dhe siguron një proces të qartë dhe të rregullt të menaxhimit të programit. <i>Evidenca 4.1 Urdhër për hapjen e programit MP ZKN</i> <i>Evidenca 4.3 Rrregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.14. Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i>
Konkluzione	GVJ vlerëson se programi i studimit Master Profesional në “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” është i strukturuar në përputhje me kriteret ligjore dhe standardet e arsimit të lartë. Ai përmban një plan mësimor të qartë dhe të detajuar, duke siguruar një ndarje të mirëpërcaktuar të lëndëve në semestre, ngarkesën mësimore të moduleve dhe shpërndarjen e orëve në auditor dhe jashtë tij.

	<i>Programi, i organizuar në dy semestra me një total prej 60 kreditesh dhe 1500 orë mësimore vjetore, kombinon në mënyrë të ekuilibruar njohuritë teorike me përvojën praktike, duke përfshirë leksione, seminare, praktika profesionale dhe studim individual.</i> <i>Gjithashtu, ky program përmban objektiva formues të qartë dhe të përshtatshëm për nivelin e studimeve të ciklit të dytë, duke pajisur studentët me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë profesionale. Struktura e tij siguron një qasje të organizuar dhe efikase ndaj procesit akademik, duke garantuar një përvojë cilësore të të nxëniet dhe zhvillim të mëtijshëm profesional. Për më tepër, transparenca dhe qasja e lehtë ndaj informacionit akademik dhe administrativ ndihmojnë në menaxhimin efektiv të programit dhe përmbushjen e objektivave të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtijshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave në programin e studimit “Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim” janë të strukturuar në mënyrë që të mundësojnë thellimin e njohurive dhe aftësive të studentëve për studime të mëtijshme dhe/ose për punësimin e tyre. Çdo lëndë dhe aktivitet formues është i strukturuar për të zhvilluar aftësitë e nevojshme në fushën e zgjidhjes së konflikteve, ndërmjetësimin dhe të drejtësisë, duke siguruar që studentët të kenë njohuri të thelluara dhe të përgatiten për një karrierë profesionale. Struktura e programit ofron gjithashtu një përgatitje të thelluar dhe të mirëfilltë për studime të mëtijshme, duke krijuar një bazë të qëndrueshme dhe dinamike për studentët, e cila i mundëson atyre

	të avancojnë në ciklin e tretë të studimeve ose të integrohen me sukses në tregun e punës. <i>Evidenca 4.5 Plan i miratuar mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i>																														
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënës dhe kërkimit shkencor.	Shpërndarja e lëndëve dhe moduleve sipas kategorive në ECTS për programin e studimit është si më poshtë: <table><tr><th>Kategoria</th><th>Tipi</th><th>ECTS</th><th>%</th><th>Standardi</th></tr><tr><td>A</td><td>Lëndë Bazë</td><td>4</td><td>6.6%</td><td>5-10 %</td></tr><tr><td>B</td><td>Lëndë karakterizuese</td><td>24</td><td>40 %</td><td>30-40 %</td></tr><tr><td>C</td><td>Lëndë ndërdisiplinore / integruese</td><td>14</td><td>23.3 %</td><td>20-30 %</td></tr><tr><td>D</td><td>Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale</td><td>6</td><td>10 %</td><td>10%</td></tr><tr><td>E</td><td>Detyrime përmbyllëse/ Provimi perfundimtar</td><td>12</td><td>20 %</td><td>10-20 %</td></tr></table> Shqyrtimi i tyre tregon se ka një luhatje të vogël, ku gjenden më shumë lëndë mësimore të kategorisë A (Lëndë bazë) në Planin Mësimor të shprehura në 6.6 % të krediteve, në raport me 5 - 10% kredite të përcaktuara në VKM, nr. 41/2018 për këtë kategori; Lëndët/modulet, shpërndarja e tyre në vite dhe semestre, si dhe vlerësimi në kredite dhe orët mësimore të programit “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”, janë të strukturuar në mënyrë që të mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe të sigurojnë rezultatet e pritshme të të nxënës dhe kërkimit shkencor. Kjo shpërndarje e lëndëve siguron një progres të balancuar të njohurive dhe aftësive, duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive praktike dhe teorike të studentëve. Vlerësimi i krediteve dhe orëve mësimore është në përputhje me kërkesat e Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), duke mundësuar një proces të qartë dhe të efektshëm të vlerësimit dhe	Kategoria	Tipi	ECTS	%	Standardi	A	Lëndë Bazë	4	6.6%	5-10 %	B	Lëndë karakterizuese	24	40 %	30-40 %	C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	14	23.3 %	20-30 %	D	Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale	6	10 %	10%	E	Detyrime përmbyllëse/ Provimi perfundimtar	12	20 %	10-20 %
Kategoria	Tipi	ECTS	%	Standardi																											
A	Lëndë Bazë	4	6.6%	5-10 %																											
B	Lëndë karakterizuese	24	40 %	30-40 %																											
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	14	23.3 %	20-30 %																											
D	Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale	6	10 %	10%																											
E	Detyrime përmbyllëse/ Provimi perfundimtar	12	20 %	10-20 %																											

	përgatitjes shkencore, që mbështet zhvillimin e kërkimit dhe rritjen e cilësisë së studimeve. <i>Evidenca 4.5 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.5.3 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E (Tabela 9)</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Struktura e programit të studimit “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”, përfshirë lëndët dhe raportin teori-praktikë, është në përputhje me profilin e programit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Ky program është i strukturuar për të ofruar një balancë të duhur mes njohurive teorike dhe praktikes, duke siguruar që studentët të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të trajtuar sfidat profesionale në fushën e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konfliktëve. Në rastin e programit të studimit “Master Profesional”, ky program siguron aftësi dhe kompetenca të thelluara profesionale, përgatit studentët për detyra të larta në nivel profesional dhe ndihmon në zhvillimin e një formimi të thelluar në këtë fushë, duke i mundësuar atyre të përballen me situata komplekse dhe të bëjnë kontribuime të rëndësishme në fushat përkatëse. <i>Evidenca 4.5 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.5.3 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E (Tabela 9)</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i> <i>Evidenca 4.17 Modeli suplementi i diplomës</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja e veprimtarive formuese dhe raporti mes formimit teorik dhe praktik në programin e studimit “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” janë të strukturuar në mënyrë që të mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit. Ky balancim midis teorisë dhe praktikës siguron zhvillimin e aftësive të nevojshme për të përballuar sfida profesionale dhe kërkesa akademike, duke mundësuar transferimin e studimeve dhe mobilitetin ndërkombëtar. Për më tepër, struktura e programit është projektuar për të përgatitur studentët për punësim pas përfundimit të studimeve, duke ofruar njohuri dhe aftësi që janë të kërkuara nga tregu i punës dhe të përshtatshme për mundësi karriere në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ky organizim kontribuon në një përvojë mësimore gjithëpërfshirëse, që rrit mundësitë për punësim dhe zhvillim profesional të studentëve.




	<i>Evidenca 4.5 Plani i miratuar mësitor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.5.3 Plani mësitor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E (Tabela 9)</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Syllabuset (programet e lëndëve/moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar që kompetencat e ofruara në programin e studimit “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Ky përditësim i vazhdueshëm përfshin përzgjedhjen e literaturës bazë dhe ndihmëse të fundit, që reflekton zhvillimet më të reja në fushën e zgjidhjes së konfliktëve dhe ndërmjetësimit. Ky proces siguron që studentët të jenë të përgatitur për kërkesat e tregut dhe të zhvillojnë aftësitë dhe njohuritë më të reja, të cilat janë të kërkuara dhe të rëndësishme për suksesin e tyre profesional në të ardhmen. <i>Evidenca 3.2 strategjia e zhvillimit të Departamentit të Sociologjisë</i> <i>Evidenca 3.3 rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara nga studentët. Struktura e programit është e projektuar në mënyrë që të sigurojë një balancë të duhur mes teorisë dhe praktikës, duke mundësuar zhvillimin e njohurive të thelluara dhe aftësive praktike të nevojshme për të përballuar sfidat profesionale në fushën e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konfliktëve. Aktivitetet formuese dhe veprimtaritë praktike, së bashku me metodologjitë e mësimdhënies, janë të orientuara për të siguruar që studentët të arrijnë rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe të zhvillojnë kompetencat e kërkuara për të pasur sukses në tregun e punës dhe studimet e mëtejshme. <i>Evidenca 4.5 Plani i miratuar mësitor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.5.3 Plani mësitor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E (Tabela 9)</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit e	Përmbajtja e programit të studimit “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit e studentëve, duke qenë plotësisht në përputhje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. Programi është i strukturuar për të ofruar njohuri dhe aftësi që

studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	janë të nevojshme për përballimin e sfidave profesionale, duke i përgatitur studentët për mundësitë e punësimit në sektorë të ndryshëm, si dhe për studime të mëtejshme në nivele të avancuara. Struktura e tij fleksibël dhe përditësimi i vazhdueshëm i përmbajtjes dhe metodologjisë siguron që studentët të jenë të pajisur me kompetencat që kërkohen nga tregu i punës dhe të kenë mundësi për të zhvilluar karrierë të suksesshme. <i>Evidenca 4.3 Rrregulllore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 1.26. Studimi-i-tregut-te-punes_UT 2022</i> <i>Evidenca 4.17 Model suplementi i diplomës</i>			
Konkluzione	<i>Në përfundim GVJ konstaton se Departamenti i Sociologjisë, , disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit;</i> <i>Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit si dhe të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecures së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin	Programi i studimit zhvillohet në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke integruar vazhdimisht propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve dhe aktorëve të tjerë të fushës. Ky proces konsultimi dhe feedback-u i rregullt siguron përditësimin e vazhdueshëm të programit dhe përshtatjen e tij me zhvillimet më të fundit në fushën e zgjidhjes së konflikteve dhe ndërmjetësimit, duke garantuar që studentët të fitojnë aftësi dhe njohuri të kërkuara nga punëdhënësit. Më konkretisht në Departamentin e Sociologjisë, analiza dhe përmirësimi i




parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	programeve të studimit realizohet nëpërmjet raporteve vjetore të punës, vlerësimeve të cilësisë nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe vetëvlerësimeve periodike. Për këtë qëllim, departamenti organizon takime të rregullta me personelin akademik dhe aktorë të ndryshëm të tregut të punës për të reflektuar mbi përmirësimin e përmbajtjes mësimore dhe përshtatjen me nevojat e tregut. Gjithashtu, bashkëpunimi me aktorët e tregut të punës, veçanërisht për praktikat mësimore, lehtëson integrimin profesional të studentëve dhe rrit mundësitë e tyre për punësim. <i>Evidenca 3.7 Raporti vjetor e Departamentit të Sociologjisë 2022-2023/2023-2024</i> <i>Evidenca 4.23 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte Periodike NJSBC 2023, 2024</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimeve institucionale, GVJ konstatoi se njësia bazë angazhohet në mënyrë të vazhdueshme në procesin e përfshirjes së studentëve dhe strukturave të tyre përmes anketimeve periodike dhe organizimit të konferencave shkencore të përbashkëta. Strategjia e konsultimit dhe ruajtjes së kontakteve me të diplomuarit shërben si një mekanizëm i rëndësishëm për mbledhjen e kontributit të tyre profesional, duke mundësuar përshtatjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe objektivat akademike. <i>Evidenca 3.2 Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Sociologjisë</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Për të siguruar përditësimin dhe përshtatshmërinë e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet në fushën e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve, <i>GVJ rekomandon zgjerimin e konsultimeve me aktorë të ndryshëm dhe institucione relevante në vend.</i> Këto bashkëpunime mundësojnë një kuptim më të thellë të nevojave profesionale dhe tregut të punës, duke u reflektuar në përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Një qasje e tillë garanton ruajtjen e cilësisë dhe relevancës akademike, duke i pajisur studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur standardet dhe praktikat më të mira profesionale në fushën e tyre.

Konkluzione	Në përfundim, GVJ konstaton se njësia bazë ka përfshirë në mënyrë aktive studentët dhe strukturat e tyre përmes anketimeve dhe organizimit të konferencave shkencore të përbashkëta, si dhe ka ndërtuar mekanizma efektivë të komunikimit me studentët e diplomuar. Megjithatë, <u>GVJ rekomandon</u> që Departamenti i Sociologjisë të zgjerojë bashkëpunimin me aktorë të ndryshëm në vend dhe të hartojë një strategji të strukturuar për konsultime të rregullta dhe të vazhdueshme me palët e interesuara, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Kjo do të mundësojë identifikimin dhe përthithjen e nevojave reale të tregut të punës, duke u reflektuar më tej në përmirësimin e përmbajtjes akademike dhe tematikave të lëndëve të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” është konceptuar në përputhje me objektivat madhorë të institucionit, duke përcaktuar qartë prioritetet akademike dhe kërkimore në këtë fushë. Ai synon t’u ofrojë studentëve njohuri të thelluara dhe aftësi praktike në ndërmjetësim dhe zgjidhjen e konfliktëve, duke ndihmuar njëkohësisht në zhvillimin e kërkimit shkencor. Objektivat e programit janë të harmonizuara me nevojat e tregut të punës dhe strategjitë institucionale, duke mbështetur integrimin e njohurive teorike me aplikimin praktik. Struktura e tij e mirëkoordinuar garanton një zhvillim të qëndrueshëm të studimeve dhe kërkimit shkencor, duke i përgatitur studentët për sfidat profesionale dhe duke kontribuar në avancimin e fushës si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. <i>Evidenca 3.2 Strategjia e Zhvillimit të Departamentit të Sociologjisë</i> <i>Evidenca 2.3. Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2023-2028</i>

	<i>Evidenca 3.11 Strategjia e kërkimit shkencor për DS 2020-2024</i> <i>Evidenca 3.12 Vendim i DS për miratimin e prioritetëve të kërkimit shkencor</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe takimeve me stafin akademik, GVJ konstaton se institucioni respekton dhe promovon lirinë akademike të personelit akademik, duke mbështetur zhvillimin e tyre shkencor dhe profesional. Departamenti i Sociologjisë bashkërendon dhe administron në mënyrë efikase veprimtaritë akademike dhe kërkimore, duke garantuar një mjedis të hapur dhe të organizuar për kërkimin shkencor dhe mësimdhënien. Ky model menaxhimi siguron që personeli akademik të ketë mundësinë të zhvillojë dhe avancojë kërkimin në mënyrë të pavarur, ndërsa studentët të përfshihen në aktivitete që pasqyrojnë më së miri nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet shkencore të fushës. Për më tepër, realizimi i analizave mbi cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të programit, duke garantuar standarde të larta akademike dhe një përvojë studimore cilësore. <i>1.2. Statuti 2018</i> <i>1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës-2022</i> <i>2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>4.3 Rregullore e Programit të Studimit</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” ofron mundësi të konsiderueshme për studentët që të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore, duke nxitur zhvillimin e aftësive të avancuara dhe aplikimin e njohurive teorike në kontekst praktik. Struktura e programit synon të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të studentëve në kërkime shkencore dhe projekte që lidhen me ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e konfliktëve, si dhe të forcojë bashkëpunimin me ekspertë dhe profesionistë të fushës. Me konkretisht, në përputhje me prioritetet akademike të Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Departamentit të Sociologjisë, studentët e këtij programi marrin mbështetje të konsiderueshme për përfshirjen e tyre në kërkimin shkencor. Universiteti organizon një konferencë shkencore ndërkombëtare vjetore, ku studentët e Departamentit të Sociologjisë kanë përfaqësuar një peshë specifike prej 45% të pjesëmarrësve në panelin e shkencave

	sociale. Fakulteti dhe departamenti nxisin dhe mbështetin aktivisht përfshirjen e studentëve në projekte kërkimore institucionale dhe akademike, duke përfshirë iniciativa të rëndësishme si botimi dhe simpoziumi “Ndikimet 4”. Gjithashtu, studentët inkurajohen të marrin pjesë në trajnime dhe projekte të ndryshme me fokus zhvillimin akademik dhe profesional, duke u përgatitur për një karrierë të suksesshme në fushën e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve. <i>Evidenca 3.22 (2) Dosje e leksioneve/aktiviteve konferencave të hapura/Axhenda e simpoziumit “Ndikimet 4”</i> <i>Evidenca 3.13 Aktivizim i studentëve në aktivitete të njësisë (Tabela 22)</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Programi i studimit Master Profesional në “Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim” siguron mbështetje financiare për zhvillimin akademik dhe kërkimor, duke garantuar burime të mjaftueshme për realizimin e aktiviteteve shkencore dhe përfshirjen e studentëve në kërkime. Departamenti i Sociologjisë buxheton rregullisht konferenca, botimin e revistës “Lente Sociologjike” dhe përkthimin e teksteve akademike, ndërsa Fakulteti i Shkencave Sociale mbështet financiarisht publikimet dhe projektet kërkimore. Kjo qasje siguron një mjedis të qëndrueshëm për kërkimin shkencor dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit. <i>Evidenca 1.16. Udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor në UT</i> <i>Evidenca 1.18. Vendim BA Për miratimin e programit të Grantit për konferenca ndërkombëtare</i> <i>Evidenca 3.11 Strategjia e kërkimit shkencor për DS 2020-2024</i> <i>Evidenca 3.15 Projektbuxhet afatmesëm 2022-2025</i>
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se programi i studimit është plotësisht në përputhje me objektivat strategjike të institucionit dhe menaxhohet në mënyrë efektive nga njësia bazë, e cila garanton burimet e nevojshme për një funksionim të suksesshëm dhe të qëndrueshëm. Nëpërmjet analizave periodike, njësia kryesore vlerëson cilësinë e procesit mësimor dhe kërkimor, duke siguruar përputhjen e programit me standardet akademike dhe kërkesat e tregut të punës.</i> <i>Njësia respekton dhe promovon lirinë akademike të pedagogëve, duke inkurajuar zhvillimin e tyre profesional dhe shkencor</i>


	përmes mbështetjes financiare për projekte, publikime dhe kërkime shkencore. Për më tepër, duke eliminuar pengesat burokratike dhe duke ndjekur një procedurë transparente e të standardizuar, krijohet një mjedis akademik i hapur dhe frytdhënës. Kjo qasje jo vetëm që forcon kapacitetet kërkimore dhe akademike, por gjithashtu rrit cilësinë e mësimdhënies, duke e bërë programin një model të shkëlqyer të përputhjes midis formimit akademik dhe kërkesave të tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Njësia përgjegjëse për programin “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore, duke siguruar bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore brenda dhe jashtë institucionit. Ky bashkëpunim forcon lidhjen mes teorisë dhe praktikës, duke orientuar aktivitetet kërkimore drejt objektivave të programit dhe kërkesave të tregut të punës. Pjesëmarrësit kanë mundësi të kontribuojnë në kërkime të avancuara në fushën e ndërmjetësimit, duke siguruar zhvillim të vazhdueshëm dhe përgatitje të mirë për profesionistët e ardhshëm. <i>Evidenca 3.22 (2) Dosje e leksioneve/aktiviteve konferencave të hapura/Axhenda e simpoziumit “Ndikimet 4”</i> <i>Evidenca 4.27 Linqe me aktivitete kërkimore dhe akademike.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për	Njësia përgjegjëse për programin “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” angazhohet aktivisht për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime dhe projekte me karakter kërkimor shkencor. Ajo siguron mbështetje të qëndrueshme për realizimin e këtyre projekteve, duke përfshirë aktivizimin e personelit akademik dhe studentëve në aktivitete kërkimore që lidhen drejtpërdrejt me objektivat e programit. Ky angazhim i njësisë përgjegjëse mundëson një bashkëpunim efektiv midis personelit akademik


realizimin e këtyre objektivave.	dhe studentëve, duke krijuar mundësi për zhvillimin e kërkimeve të reja dhe për thellimin e njohurive në fushën e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve. Pjesëmarrja e studentëve në këto aktivitete kërkimore i ofron atyre mundësinë për të zbatuar teoritë dhe metodologjitë e mësuara në studime, si dhe për të kontribuar në zhvillimin e fushës. Ky proces angazhon gjithashtu programin për të qëndruar në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet e reja në kërkimin shkencor, duke ndihmuar në avancimin e njohurive dhe aplikimeve praktike në fushën e ndërmjetësimit. <i>Evidenca 3.16 Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit (tabela 19).pdf</i> <i>Evidenca 3.13 Aktivizim i studentëve në aktivitete të njësisë (Tabela 22).pdf</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Njësia përgjegjëse për programin “Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim” organizon konferenca, seminare dhe aktivitete të tjera që kontribuojnë në arritjen e objektivave të programit të studimit. Këto aktivitete krijojnë mundësi të shumta për studentët dhe personelin akademik për të shkëmbyer njohuri dhe praktika, për të thelluar njohuritë e tyre në fushën e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve, dhe për të kontribuar në zhvillimin e kërkimit shkencor. Organizimi i konferencave dhe aktiviteteve të ngjashme lehtëson aksesin në burime të reja informacioni, inkurajon diskutime të hapura dhe stimulon bashkëpunimin mes ekspertëve të fushës dhe pjesëmarrësve të programit. Këto aktivitete janë të rëndësishme për zhvillimin e aftësive kërkimore dhe profesionale të studentëve, duke i përgatitur ata për sfidat e tregut të punës dhe duke kontribuar në avancimin e fushës në nivel akademik dhe profesional. <i>Evidenca 3.7 Raporti vjetor e Departamentit të Sociologjisë 2022-2023/2023-2024</i> <i>Evidenca 4.27 Linqe me aktivitete kërkimore dhe akademike</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit “Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim” është i strukturuar në mënyrë që të formojë profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Ai siguron zhvillimin e aftësive dhe kompetencave të nevojshme për të përballuar sfidat e fushës së ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve, duke i përgatitur studentët për një karrierë të

	suksesshme në sektorë të ndryshëm. Përmes një përmbajtjeje të fortë akademike dhe praktike, programi ofron mundësi për të zhvilluar njohuri të avancuara dhe aftësi të veçanta që janë të kërkuara në tregun e punës, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Ky program i fokusuar gjithashtu siguron që studentët të jenë të aftë të operojnë në një mjedis global, duke e bërë ata konkurrues dhe të gatshëm për të kontribuar në zgjidhjen e konflikteve dhe përparimin e shoqërive të ndryshme. <i>Evidenca 4.3 Rrregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.2 strategjia e zhvillimit të Departamentit të Sociologjisë</i> <i>Evidenca 4.2 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Programi “Master Profesional në Zgjidhjen e Konflikteve me Ndërmjetësim”, i zhvilluar nga Departamenti i Sociologjisë, është konceptuar në mënyrë të tillë që të përputhet plotësisht me kërkesat ligjore dhe profesionale për përgatitjen e ndërmjetësve të ardhshëm. Në hartimin e tij janë marrë parasysh jo vetëm dispozitat e Ligjit nr. 10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” (i ndryshuar), por edhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe rekomandimet e shoqatave profesionale në fushën e ndërmjetësimin. Struktura dhe përmbajtja e programit janë ndërtuar për të siguruar që studentët të fitojnë të gjitha kompetencat teorike dhe praktike të kërkuara për ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit. Lëndët përfshijnë tematika që mbulojnë tipologjitë e konflikteve, aspektet ligjore të ndërmjetësimin, psikologjinë e konfliktit, komunikimin profesional, drejtësinë restauruese, si dhe metodat alternative të zgjidhjes së konflikteve. Përveç kësaj, programi parashikon zhvillimin e praktikës profesionale, e cila i lejon studentët të përfshihen drejtpërdrejt në situata reale të ndërmjetësimin, duke përforcuar aftësitë e tyre praktike dhe etike. Në përputhje me kërkesat e ligjit për ndërmjetësimin, përfundimi me sukses i këtij programi i mundëson të diplomuarve të plotësojnë një nga kushtet kryesore për të aplikuar për licencimin si ndërmjetës pranë institucioneve përkatëse. Gjithashtu, janë marrë parasysh edhe rekomandimet e shoqatave profesionale dhe rrjeteve të ndërmjetësimin, të cilat kanë ndikuar në përditësimin e përmbajtjes së programit dhe në përafrimin e tij me standardet më të mira evropiane dhe ndërkombëtare.




	Ky program është gjithashtu i dobishëm për profesionistë të fushave të tjera që përballen me menaxhimin e konflikteve në punën e tyre të përditshme, si mësues, punonjës socialë, oficerë sigurie, specialistë të shërbimeve penitenciare dhe të Shërbimit të Provës, duke kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm profesional të tyre. Në këtë mënyrë, njësia përgjegjëse ka siguruar që programi të jetë në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe rekomandimet e shoqatave profesionale, duke u ofruar studentëve një formim të plotë dhe të kualifikuar për ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi “Master Profesional në Zgjidhjen e Konflikteve me Ndërmjetësim” është projektuar duke marrë në konsideratë kërkesat ligjore kombëtare për përgatitjen dhe ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit, siç përcaktohen në Ligjin nr. 10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Struktura e programit, lëndët e përfshira dhe praktika profesionale janë ndërtuar për të siguruar që të diplomuarit të përmbushin të gjitha kompetencat dhe kriteret që kërkojnë për licencimin dhe ushtrimin e profesionit në Shqipëri. Në hartimin e programit janë marrë në konsideratë edhe standardet dhe praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian dhe të universiteteve të njohura ndërkombëtare në fushën e ndërmjetësimit dhe menaxhimit të konflikteve. Përmbajtja e programit është përafër me rekomandimet e shoqatave profesionale dhe rrjeteve evropiane të ndërmjetësimit, duke synuar që formimi i studentëve të jetë në linjë me zhvillimet bashkëkohore të fushës dhe të lehtësojë njohjen e kualifikimeve edhe jashtë vendit. Në këtë mënyrë, programi garanton përputhshmëri të plotë me kuadrin ligjor kombëtar dhe është i harmonizuar me orientimet ndërkombëtare për profesionet e rregulluara, duke u ofruar studentëve një formim të vlefshëm për tregun vendas dhe atë evropian të punës.
Konkluzione	<i>Në përfundim, GVJ konstatoi se njësia përgjegjëse ofron mbështetje të qëndrueshme për grupet kërkimore-shkencore dhe ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi, duke financuar gjithashtu punën shkencore të stafit akademik. Ajo</i>




	angazhon në mënyrë të vazhdueshme personelin akademik dhe studentët në projekte të ndryshme, si konferenca shkencore dhe studime, duke siguruar një mjedis akademik të pasur dhe të zhvilluar për përparimin e kërkimit dhe përgatitjen e studentëve për sfidat e ardhshme profesionale. Ky angazhim i vazhdueshëm përmbush objektivat strategjike të programit dhe siguron që aktivitetet shkencore dhe mësimore të jenë të përshtatshme dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet ndërkombëtare. Me këtë qasje, programi kontribuon në avancimin e fushës së zgjidhjes së konflikteve me ndërmjetësim dhe përgatit profesionistë të kualifikuar që mund të përballen me sfida globale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e	Programi i studimit MP “Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim” integron një sërë metodash bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke kombinuar leksione teorike, seminare, detyra kursi, ese, projekte dhe praktika profesionale. Këto metoda sigurojnë një qasje gjithëpërfshirëse, duke i pajisur studentët me aftësi analitike, kritike dhe praktike të domosdoshme për fushën e ndërmjetësimit. Një komponent kyç i programit është praktika profesionale, e cila u mundëson studentëve të zbatojnë njohuritë në situata reale, duke fituar

hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	përvojë të drejtpërdrejtë dhe aftësi të avancuara në trajtimin e konflikteve. Përmes seminareve dhe projekteve kërkimore, studentët angazhohen në analizën dhe aplikimin e koncepteve kryesore, ndërsa orët e hapura për diskutime dhe mbështetje akademike ndihmojnë në thellimin e njohurive dhe zhvillimin e mendimit kritik. Kjo strukturë e mirëorganizuar përgatit studentët për sfidat e tregut të punës, duke i aftësuar për të kontribuar në mënyrë aktive në fushën e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve. <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i> <i>Evidenca 4.5 Plani i miratuar mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.5.1 Plani mësimor sipas modelit të tabelës 10</i> <i>Evidenca 3.22 (2) Dosje e leksioneve/aktiviteve konferencave të hapura/Axhenda e simpoziumit "Ndikimet 4"</i> <i>Evidenca 3.20 Të dhëna për mobilitetin e studentëve</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik i programit "Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim" respekton diversitetin dhe nevojat e studentëve, duke ofruar një qasje fleksibile dhe gjithëpërfshirëse në mësimdhënie. Përmes metodave të ndryshme si leksione, seminare, detyra kursi etj, sigurohet një përshtatje me stilin dhe ritmin individual të të nxënit. Gjithashtu, studentëve u ofrohet mundësi për konsultime dhe mbështetje shtesë për të përmirësuar performancën e tyre akademike. Kjo qasje krijon një mjedis mësimor të hapur dhe motivues, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe të përgatiten për sfidat profesionale në fushën e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve. <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Departamenti Sociologjisë mbështet personelin akademik në përmirësimin e vazhdueshëm të kompetencave didaktike, duke ofruar mundësi për trajnime, seminare që janë të orientuara nga rezultatet e pritshme të të nxënit. Kjo mbështetje siguron që mësimdhënia të jetë në përputhje me kërkesat dhe standardet më të larta të arsimit të lartë, duke përmirësuar aftësitë pedagogjike dhe profesionale të stafit akademik. Po ashtu, institucioni ofron mundësi për zhvillimin e metodave dhe teknikave të reja mësimore që ndihmojnë në arritjen e rezultateve të përcaktuara për çdo program studimi. Ky angazhim për zhvillimin e vazhdueshëm të personelit akademik



	është i rëndësishëm për të siguruar që procesi mësimor të jetë efektiv dhe të mundësojë arritjen e qëllimeve të programit “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”, duke kontribuar kështu në përgatitjen e studentëve për sfidat e tregut të punës dhe profesionit. <i>Evidenca 1.20. Vendim SA për ngritjen e qendrës virtuale të trajnimit dhe zhvillimit profesional</i> <i>Evidenca 1.25. Plan i strategjik i UT për zhvillimin e personelit akademik 2023-2028 VS-6-date-30.01.2023</i> <i>Evidenca 3.27 Mundësi dhe hapësira trajnimi për personelin akademik</i> <i>Evidenca 2.3. Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2023-2028</i> <i>Evidenca 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17</i> <i>Evidenca 2.28. Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i programit “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” respekton dhe u përgjigjet nevojave të ndryshme të studentëve, duke ofruar një shumëllojshmëri metodash dhe mundësish alternative për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Kjo përfshin fleksibilitet në përdorimin e formave të ndryshme si leksione, seminare, mësim të orientuar nga studentët, mbështetje online dhe detyra kursi, të cilat përshtaten me ritmin dhe stilin e të nxënës të secilit student. Gjithashtu, personeli akademik ofron konsultime dhe mbështetje shtesë për studentët që kanë nevojë të veçanta ose që kërkojnë ndihmë për të përmirësuar rezultatet e tyre akademike. Kjo qasje gjithëpërfshirëse krijon një mjedis mësimor të hapur dhe mbështetës, duke i ndihmuar studentët të zhvillojnë plotësisht aftësitë e tyre dhe të angazhohen në mënyrë aktive në procesin e të nxënës. Përdorimi i këtyre metodave të larmishme është një aspekt kyç për mbështetjen e studentëve, duke i përgatitur ata për sfidat profesionale në fushën e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konfliktëve. <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018</i> <i>Evidenca 2.19. Model i Marrëveshjes për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik</i> <i>Evidenca 4.15 CV e personelit akademik dhe ndihmës akademik për programin e studimit</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të	Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” ka një praktikë të rregullt dhe

studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	të sistematizuar për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave dhe formave të mësimdhënies. Ky proces përfshin gjithashtu studentët, të cilët janë të angazhuar në mënyrë aktive për të dhënë mendimet e tyre dhe sugjerimet lidhur me metodat mësimore nëpërmjet pyetësorëve periodikë, duke krijuar mundësi për të reflektuar mbi procesin e mësimdhënies dhe për të bërë përmirësime të qëndrueshme. Njësia përkatëse merr parasysh këto reagime dhe i integrojnë ato në praktikat e saj, duke siguruar që format dhe metodat mësimore të mbeten të përshtatshme dhe efektive për të arritur rezultatet e pritshme të nxënit. Ky angazhim i vazhdueshëm për përmirësim dhe përfshirja e studentëve në këtë proces është një tregues i një kulture mësimore të orientuar nga cilësia dhe përmirësimi i përhershëm, duke ndihmuar në zhvillimin e aftësive dhe kompetencave të studentëve dhe duke siguruar përgatitjen e tyre të plotë për sfidat e profesionit. <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024.pdf</i> <i>Evidenca 3.7 Raporti vjetor e Departamentit të Sociologjisë 2022-2023/2023-2024</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Institucioni ka krijuar struktura dhe njësitë përkatëse që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, duke siguruar një koordinim të fortë dhe bashkërendim midis njësive kryesore/bazë dhe struktura të tjera akademike. Këto struktura janë përgjegjëse për mbështetje dhe orientim të aktiviteteve të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe ofrojnë mundësi për eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies. Po ashtu, këto njësitë sigurojnë trajnime të vazhdueshme për personelin akademik, duke i mundësuar atyre përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe adoptimin e metodave të reja dhe efektive që mundësojnë një mësimdhënie më interaktive dhe studentëve që angazhohen më thellë në procesin e të nxënit. Ky angazhim për përmirësimin e vazhdueshëm dhe mbështetje për eksperimentimin me metodat e reja ndihmon në garantimin e cilësisë së lartë të arsimit dhe përgatitjen e studentëve për profesionin e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe standardet ndërkombëtare. <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i>




	<i>Evidenca 3.23 Orare konsultimi me studentë</i> <i>Evidenca 1.25. Plani strategjik i UT per zhvillimin e personelit akademik 2023-2028 VS-6-date-30.01.2023</i> <i>Evidenca 3.27 Mundësi dhe hapësira trajnimi për personelin akademik</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se programi i studimit “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” ofron një strukturë akademike të mirëorganizuar dhe në përputhje me standardet institucionale dhe ligjore. Programi mbështet zhvillimin profesional të studentëve përmes metodave të ndryshme mësimore, aktiviteteve kërkimore dhe bashkëpunimeve akademike, duke siguruar një mjedis të favorshëm për arritjen e objektivave të tij.</i> <i>Gjithashtu, angazhimi i njësive përgjegjëse në mbështetjen e stafit akademik dhe studentëve, si dhe përdorimi i resurseve të nevojshme, garanton një përgatitje cilësore dhe të aplikueshme në praktikë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore në programin “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e programit të studimit dhe bëhen publike për studentët që në fillim të secilit semestër. Vlerësimi është shumëdimensional, duke përfshirë provime teorike, punime kërkimore, detyra praktike dhe shqyrtimin e rasteve studimore, dhe pasqyron nevojën për zhvillimin e aftësive praktike në ndërmjetësim dhe zgjidhjen e konfliktëve. Ky sistem vlerësimi është transparent dhe mundëson reagime të vazhdueshme, duke kontribuar në përmirësimin e procesit edukativ dhe në zhvillimin e kompetencave të studentëve.



	<i>Evidenca 1.3. rregullore e universitetit te tiranes 2022</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.3 Rrregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në programin “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”, studentët janë informuar në mënyrë të detajuar dhe transparente për metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore që do të përdoren gjatë çdo lënde/moduli. Ky informacion u jepet studentëve nga titullarët e lëndëve/modulave në fillim të secilës lëndë, përmes syllabuseve përkatëse, të cilat përfshijnë metodën e vlerësimit, kritere specifike dhe format e testeve (p sh. provime, detyra praktike, punime kërkimore, etj.). Ky proces siguron që studentët të kenë një kuptim të qartë të kërkesave dhe të mundësive për të treguar njohuritë dhe aftësitë e tyre në mënyrë të drejtë dhe të strukturuar, duke krijuar mundësinë për përgatitje më të mirë dhe transparencë në vlerësim. <i>Evidenca 4.3 Rrregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Në programin MP “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”, testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke u ofruar studentëve mundësinë për të demonstruar njohuritë dhe kompetencat e fituara në disa nivele. Këto përfshijnë provime teorike, detyra praktike, punime kërkimore, simulime, dhe analiza të rasteve të vërteta të ndërmjetësimit. Përdorimi i një gamë të gjerë metodash vlerësimi siguron një qasje të plotë dhe gjithëpërfshirëse në matjen e aftësive të studentëve, duke i mundësuar atyre të tregojnë kompetencat e tyre në mënyrë të ndryshme dhe përmes situatave reale. Kjo qasje gjithashtu rrit mundësinë për të vlerësuar si njohuritë teorike, ashtu edhe aftësitë praktike që janë thelbësore për profesionistët e ardhshëm në fushën e zgjidhjes së konfliktëve. <i>Evidenca 1.3. rregullore e universitetit te tiranes 2022</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i>

	<i>Evidenca 4.3 Rrregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni harton rregullore dhe procedura të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</i> <i>Studentët informohen paraprakisht me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, ne perputhje me rregulloet e IAL.</i> <i>Procesi i vlerësimit është shumëdimensional dhe përfshin metoda të ndryshme si provime teorike, punime kërkimore, detyra praktike dhe raste studimore. Ky sistem vlerësimi siguron transparencë dhe mundëson reagime të vazhdueshme, duke mbështetur zhvillimin e aftësive praktike të studentëve dhe duke kontribuar në përmirësimin e procesit edukativ.</i>			
Sbkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në programin MP “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”, testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke u ofruar studentëve mundësinë të demonstrojnë përparimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme. Vlerësimi është i strukturuar dhe përfshin disa komponentë, si provime të ndërmjetme, detyra praktike, punime kërkimore dhe aktivitete të tjera që mundësojnë vlerësimin e njohurive dhe aftësive gjatë gjithë periudhës së mësimdhënies. Ky vlerësim i vazhdueshëm reflektohet në vlerësimin përfundimtar, i cili është i parashikuar në syllabuset e lëndëve dhe moduleve dhe përcaktohet nga titullarët e lëndëve/moduleve. Ky sistem vlerësimi siguron që studentët të kenë mundësi të vlerësohen për çdo aspekt të zhvillimit të tyre akademik dhe profesional, duke përfshirë të

	gjitha aspektet e nevojshme për t'u përgatitur si profesionistë të suksesshëm në fushën e zgjidhjes së konflikteve. <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i> <i>Evidenca 3.12 Vendim i DS për miratimin e prioriteteve të kërkimit shkencor</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni ka integruar përdorimin e platformave elektronike për testimin dhe vlerësimin e studentëve në programin “Master Profesional në Zgjidhjen e Konflikteve me Ndërmjetësim”. Gjatë procesit të vlerësimit, studentët kanë mundësinë të kryejnë teste, kuize dhe dorëzime të detyrave përmes sistemit elektronik të menaxhimit të mësimin (LMS), i cili përdoret gjerësisht në nivel fakulteti dhe universiteti. Këto sisteme mundësojnë: • Ruajtjen e çdo përgjigjeje të studentëve dhe aksesin e kontrolluar nga stafi akademik, • Gjenerimin automatik të rezultateve për testet objektive, • Mbajtjen e një gjurme të qartë të çdo ndërhyrjeje apo ndryshimi në vlerësime, • Raportim të detajuar për secilin student dhe transparencë në procesin e vlerësimit. Përveç kësaj, përdorimi i platformave online ndihmon në minimizimin e mundësive për abuzim, pasi çdo veprim është i regjistruar elektronikisht dhe mund të auditohet në çdo kohë nga strukturat përgjegjëse të institucionit. Studentët kanë gjithashtu mundësi të shohin notat dhe komentet e pedagogëve në kohë reale, gjë që rrit ndjeshëm transparencën dhe besimin në procesin e vlerësimit. Në rastet e vlerësimeve me prezencë fizike, institucioni aplikon procedura të standardizuara për ruajtjen e integritetit të provimeve, përfshirë identifikimin e studentëve, mbikëqyrjen gjatë testimit dhe përdorimin e formularëve të personalizuar. Në këtë mënyrë, institucioni siguron që procesi i vlerësimit të jetë i drejtë, i verifikueshëm dhe në përputhje me standardet e cilësisë, duke garantuar integritetin akademik dhe barazinë e trajtimit për të gjithë studentët.

	<i>Evidenca 1.10.1. Marrëveshje bashkëpunimi midis Albanian-American development foundation</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës në programin “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” realizohet në përputhje me përmbajtjen e syllabusit dhe me legjislacionin në fuqi. Ky proces organizohet nga komisione provimesh, të përbëra nga jo më pak se dy pedagogë, nën drejtimin e titullarit të lëndës. Komisionet janë të emëruara nga departamenti dhe të miratuara nga Dekani i Fakultetit/zv. Dekanët, në përputhje me rregulloren e fakultetit dhe të programit të studimit. Vlerësimi i përfundimtar i njohurive dhe aftësive të studentëve është i strukturuar dhe i standardizuar, duke siguruar një proces të drejtë dhe transparent, në përputhje me rregullat dhe kërkesat akademike dhe ligjore. Kjo qasje garanton integritetin e vlerësimit dhe respektimin e të drejtave të studentëve. <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në programin MP Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”, vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet gjithmonë me komente dhe feedback, kur është e nevojshme, për të mbështetur zhvillimin e studentëve. Ky feedback ofron udhëzime të detajuara dhe konstruktive për studentët, duke i ndihmuar ata të kuptojnë arsyet e rezultateve të tyre dhe t’i orientojnë për përmirësimin e mundshëm në fushat ku kanë mangësi. Po ashtu, feedback-u lidhet me këshilla dhe rekomandime mbi procesin e të nxënies, duke ndihmuar studentët të identifikojnë mënyra efektive për të përmirësuar aftësitë dhe performancën e tyre në të ardhmen. <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në programin “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”, njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik janë të angazhuar në shmangien dhe parandalimin e plagjiaturës dhe kopjimit gjatë provimeve dhe detyrave. Institucioni ka vendosur masa strikte për të siguruar integritetin akademik, për identifikimin e plagjiaturës dhe monitorimin e testimeve për të parandaluar çdo formë abuzimi. Po ashtu, janë zhvilluar rregulla të qarta dhe trajnime për studentët dhe stafin akademik, për t’u siguruar që

	çdo student është i informuar për pasojat e plagjiaturës dhe kopjimit. Kjo qasje garanton një proces të drejtë dhe transparent vlerësimi, duke rritur besueshmërinë dhe cilësinë e edukimit. <i>Evidenca 1.5. kodi-i-etikes 2011</i> <i>Evidenca 3.3 rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i> <i>Evidenca 3.6 Rregullore për diplomat e ciklit II</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në programin MP “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”, rezultatet e vlerësimit bazohen në meritë, duke garantuar një vlerësim të drejtë dhe objektiv për çdo student, i cili vlerësohet sipas performancës dhe arritjeve të tij. Rezultatet e vlerësimeve shpallen në kohë, sipas rregulloreve përkatëse, duke siguruar transparencë dhe mundësi për studentët të kenë qasje të drejtpërdrejtë në rezultatet e tyre. Ky sistem ofron mundësinë e reflektimit dhe përmirësimit të mëtejshëm, duke i dhënë studentëve mundësinë të informohen dhe të përmirësojnë performancën e tyre. Shkalla e përvetësimit të lëndës vlerësohet me 10 nota, ku nota kaluese më e ulët është 5. Rezultatet e provimeve bëhen të njohura për studentët nga pedagogu i lëndës, pasi mbyllet korrigjimi i provimeve me shkrim dhe menjëherë pas përfundimit të provimit me gojë, kur aplikohet. Pas përfundimit të provimit, shpallet zyrtarisht zgjidhja e tezës dhe data e nxjerrjes së rezultateve. Teza e provimit hartohet duke pasur parasysh nivele të ndryshme njohurish, duke filluar nga ato më të thjeshtat deri tek më të vështirat. Korrigjimi i tezës bëhet brenda 10 ditëve pune nga data e zhvillimit të provimit. <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës-2022.pdf</i> <i>rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut,	Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin e tyre dhe për të kërkuar rishikimin e tij në përputhje me rregullat e përcaktuara në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Studentët kanë mundësinë të kenë qasje të plotë në rezultatet e tyre të vlerësimit dhe të kërkojnë sqarime ose rishikimin e tyre në rast se ndjehen të pasigurt ose të pakënaqur me rezultatet e arritura. Kjo mundësi për rishikim është e rregulluar në mënyrë të detajuar, duke siguruar një proces të

rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	drejtë dhe transparent për studentët. Procedurat janë të qarta dhe të disponueshme për studentët, duke i garantuar atyre një mundësi të drejtë për të adresuar çdo shqetësim lidhur me vlerësimin e tyre. Kjo qasje kontribuon në ruajtjen e integritetit dhe besueshmërisë së sistemit të vlerësimit. <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës 2022.pdf</i> <i>rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në programin “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”, çdo kërkesë dhe ankimim i lidhur me vlerësimin shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe, nëse është e nevojshme, më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e trajtimit të këtyre kërkesave është e qartë dhe transparente për të gjitha palët e përfshira, duke siguruar që çdo ankim të trajtohet në mënyrë të drejtë dhe objektive. Çdo hap i procesit dokumentohet dhe arkivohet brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e trajtimit të kërkesave për sqarim dhe procesverbalet e provimit dorëzohen në sekretarinë mësimore duke ruajtur një gjurmë të plotë të veprimeve dhe vendimeve të marra, në mënyrë që të sigurohet përgjegjshmëri dhe transparencë. <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës 2022.pdf</i> <i>rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i>
Konkluzione	Në përfundim, GVJ konstaton se Institucioni ka zhvilluar dhe implementuar procedura të qarta dhe të strukturuar për zhvillimin e provimeve, të cilat janë të përcaktuara në akte të brendshme, përfshirë rregulloren e programit të studimit dhe udhëzimet përkatëse për provimet. Njësitë përkatëse janë përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e këtyre procedurave, duke siguruar që vlerësimi i dijeve të studentëve të realizohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara. Procedurat e vlerësimit janë të drejta dhe transparente, duke filluar që në fillim të vitit akademik, kur janë shpallur kriteret e vlerësimit në syllabuse dhe janë sqaruar nga pedagogu përpara çdo testimi. Vlerësimi bazohet në meritat e secilit student, përfshirë edhe mundësinë e ankimit, e cila sigurohet në përputhje me legjislacionin e institucionit. Këto praktika janë konfirmuar dhe verifikuar nga bisedat e zhvilluara me studentët



	<i>dhe stafin akademik, duke e garantuar kështu një proces vlerësimi të drejtë dhe të besueshëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit "Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim" garanton thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve përmes një strukture mësimore të përshkruar dhe të mirëpërcaktuar. Programi synon jo vetëm t'u ofrojë studentëve njohuri të thella teorike në fushën e zgjidhjes së konfliktëve, por gjithashtu i përgatit ata për të zhvilluar aftësi praktike dhe profesionale që janë të nevojshme për t'u bërë profesionistë të suksesshëm në këtë fushë. Përmes lëndëve të strukturuar, aktiviteteve praktike dhe projekteve të kërkimit, programi ndihmon studentët të zhvillojnë aftësi kritike, analitike dhe të ndërmjetësimit, duke u përgatitur për sfidat profesionale dhe shkencore të fushës. Kjo qasje e plotë dhe gjithëpërfshirëse siguron që studentët të arrijnë nivele të larta të kompetencës dhe të jenë të aftë të aplikojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në praktikën profesionale. <i>Evidenca 4.5.1 Plani mësimor sipas modelit të tabelës 10</i> <i>Evidenca 4.5.3 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E (Tabela 9)</i> <i>Evidenca 4.4 Korniza konceptuale e programit të studimit</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit "Zgjidhje e konfliktëve me ndërmjetësim" është hartuar në përputhje me modelet ndërkombëtare të universiteteve të prestigjioze si Columbia University, Nova Southeastern University, University of Kent, dhe Philipps-Universität Marburg, duke pasur si synim përgatitjen e profesionistëve në fushën e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konfliktëve. Ky program i ri është krijuar për të mbushur një boshllëk të rëndësishëm në arsimin e lartë në Shqipëri, duke

	ofruar mundësinë për studentët të zhvillojnë aftësi dhe kompetenca kyçe për të qenë të suksesshëm si ndërmjetësues dhe fasilitues të zgjidhjes së konflikteve. Ky program siguron zhvillimin e aftësive të veçanta në fusha të ndryshme kyçe, përfshirë përdorimin e teknologjisë së informacionit, aftësitë sociale dhe humane, dhe aftësitë e komunikimit dhe ndërveprimit. Studentët do të jenë të përgatitur për të përdorur mjetet dhe platformat digjitale në mbështetje të proceseve të ndërmjetësimit, ndërkohë që zhvillojnë aftësi të rëndësishme për menaxhimin e konflikteve dhe komunikimin efektiv. Po ashtu, programi përfshin trajnimin në komunikimin në gjuhë të huaja, duke mundësuar që studentët të punojnë dhe bashkëpunojnë në mjedise ndërkombëtare. Kjo qasje e integruar i mundëson studentëve një përgatitje të gjithanshme, duke i përgatitur ata për sfidat profesionale në një botë gjithnjë e më të globalizuar dhe teknologjikisht të avancuar. <i>Evidenca 4.4 Korniza konceptuale e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në programin e studimit “Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim”, kompetencat dhe aftësitë që studentët fitojnë janë të qarta dhe të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde. Në përfundim të çdo lënde, personeli akademik realizon një analizë dhe shqyrtim të këtyre kompetencave, duke vlerësuar përparimin e studentëve dhe duke identifikuar çështjet më të rëndësishme që ata duhet të fokusohen më tej. Gjatë këtij procesi, stafi akademik orienton studentët për mënyrat e zbatimit të aftësive të fituara dhe për detyrimet përmbyllëse që ata duhet të plotësojnë për të përfunduar lëndën me sukses. Ky orientim është i rëndësishëm për të siguruar që studentët të kenë një kuptim të plotë të kompetencave që kanë zhvilluar dhe mundësive për t’i aplikuar ato në praktikë. Gjithashtu, kjo qasje siguron një lidhje të ngushtë mes procesit të mësimdhënies dhe vlerësimit, duke rritur cilësinë e përvojës akademike dhe përgatitjen profesionale të studentëve. <i>Evidenca 4.4 Korniza konceptuale e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë	Programi i studimit “Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim” realizon mësimdhënie mbi bazë kompetencash, duke ofruar

kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	mundësi për studentët që të zhvillojnë dhe aplikojnë njohuritë e marra, jo vetëm në kontekst teorik, por edhe në praktika profesionale. Personeli akademik luan një rol kyç në mbështetje të diskutimeve dhe punës në grup, duke orientuar studentët për interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara. Kjo qasje promovon një mjedis të pasur për zhvillimin e ideve inovative dhe inkurajon studentët të kontribuojnë në studime të përparuara kërkimore e shkencore, duke i mbështetur ata në procesin e kërkimit dhe zgjidhjes së sfidave praktike. Po ashtu, programi ndërthur format e mësimdhënies me institucione bashkëpunuese, duke mundësuar mobilitetin e studentëve dhe mundësi për përvojë ndërkombëtare. Ky integrim i praktikës, kërkimit dhe bashkëpunimit me institucione të tjera rrit cilësinë e përgatitjes profesionale dhe shkencore të studentëve, duke i mundësuar atyre një përvojë më të pasur dhe të gjithanshme. <i>Evidenca 4.4 Korniza konceptuale e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.23 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese</i> <i>Evidenca 3.22 (2) Dosje e leksioneve/aktiviteve konferencave të hapura/Axhenda e simpoziumit "Ndikimet 4"</i> <i>Evidenca 4.27 Linqe me aktivitete kërkimore dhe akademike</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i> <i>Evidenca 4.8 Veprimtaria kërkimore dhe bashkëpunime ndër-institucionale 2022-2024</i> <i>Evidenca 4.24 Raport analitik nga përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i> <i>Evidenca 4.23 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese</i> <i>Evidenca 3.20 Të dhëna për mobilitetin e studentëve</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në programin "Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim", personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare si brenda ashtu edhe jashtë strukturës së programit të studimit. Këto aktivitete ofrojnë mundësi për studentët që të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me avancimet më të fundit të praktikave profesionale, duke i ndihmuar ata të qëndrojnë të përditësuar dhe të përgatitur për sfidat e ndryshimeve të fushës. Seminaret dhe orët e hapura gjithashtu krijojnë mundësi për diskutime dhe shkëmbim idesh, duke inkurajuar studentët të zhvillojnë mendimin kritik dhe të përvetësojnë njohuri të avancuara që mund të jenë të dobishme në karrierën e tyre profesionale. Ky angazhim i personelit

	akademik për të mbajtur studentët të informuar mbi zhvillimet më të fundit kontribuon në cilësinë dhe relevancën e programit të studimit. <i>Evidenca 4.15 CV e personelit akademik dhe ndihmës akademik për programin e studimit</i> <i>Evidenca 3.7 Raporti vjetor e Departamentit të Sociologjisë 2022-2023/2023-2024</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Institucioni nxit dhe mbështet zhvillimin e ideve inovative dhe studimeve të përparuara kërkimore nga studentët, duke ofruar mundësi për kërkime të avancuara dhe inovative në fushën e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve. Programi ofron një mjedis të favorshëm për krijimin dhe zhvillimin e projekteve kërkimore dhe ideve inovative që mund të kontribuojnë në avancimin e fushës. Për më tepër, institucioni ofron mbështetje financiare për projektet kërkimore të studentëve. Kjo mbështetje kontribuon në rritjen e cilësisë së punës kërkimore dhe inkurajon studentët të angazhohen më thellë në studime shkencore, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësi kërkimore dhe të kontribuojnë në zhvillimin e ideve dhe praktikave të reja në fushën e zgjidhjes së konflikteve. <i>Evidenca 1.16. Udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor në UT</i> <i>Evidenca 1.18. Vendim BA Për miratimin e programit të Grantit për konferenca ndërkombëtare</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se programi i studimit ndihmon në zhvillimin e aftësive krijuese dhe zbatuese të studentëve, por gjithashtu i pajis ata me njohuritë dhe praktikat më të mira në fushën përkatëse. Përmes një qasjeje të balancuar midis teorisë dhe praktikës, studentët aftësohen të analizojnë dhe të zgjidhin në mënyrë kritike problematika të ndryshme profesionale.</i> <i>Për më tepër, përfshirja në projekte kërkimore dhe aktivitete praktike rrit ndjeshëm kapacitetin e tyre për inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm në karrierën e tyre të ardhshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Institucioni ka hartuar një procedurë të posaçme dhe të qartë për detyrimet përmbyllëse që studentët duhet të përmbushin para realizimit të tyre. Kjo procedurë specifikon të gjitha hapat dhe kërkesat që studentët duhet të ndjekin për të përmbushur detyrimet përmbyllëse, duke siguruar një proces të strukturuar dhe të kuptueshëm. Procedura është e detajuar dhe bëhet publike për studentët përmes kanaleve të komunikimit zyrtar, si syllabus-i i lëndëve, platforma elektronike dhe dokumente të tjera relevante. Kjo qasje e transparencës siguron që studentët janë të informuar dhe të përgatitur plotësisht për të përmbushur detyrimet përmbyllëse në përputhje me kërkesat dhe standardet e institucionit, duke kontribuar kështu në një proces të drejtë dhe të planifikuar mirë. <i>Evidenca 4.3 Rrregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ofrojnë mbështetje të plotë për studentët në përmbushjen e detyrimeve përmbyllëse, duke siguruar informacionet, udhëzimet dhe materialet e nevojshme. Ky asistim garanton një proces të qartë dhe të strukturuar, duke ndihmuar studentët të përmbushin me sukses kërkesat akademike. Në programin e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në “Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim”, përfundimi i studimeve realizohet përmes një provimi përfundimtar të formimit ose një pune diplome. Departamenti dhe koordinatoret e programeve janë përgjegjës për informimin e studentëve mbi udhëzimet dhe afatet kohore të mbrojtjes së diplomës, duke siguruar një proces të rregullt dhe të suksesshëm. Fondi i pyetjeve për provimin përfundimtar miratohet nga drejtuesi i departamentit dhe më pas nga dekanati, duke u vënë në dispozicion të studentëve jo më vonë se dhjetori i vitit akademik përkatës. Ndërsa tema e diplomës zhvillohet nën drejtimin e një udhëheqësi akademik dhe mbrohet para një komisioni vlerësues, duke reflektuar aftësitë kërkimore dhe profesionale të studentit.



	<i>Evidenca 4.3 Rrregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.6 Rrregullore për diplomat e ciklit II</i>
Kriteri 3. Komisioni I posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi final në programin “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” administrohet nga një komision i posaçëm, i cili zbaton një metodologji të strukturuar dhe të drejtë për të vlerësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse njohuritë dhe aftësitë e studentëve. Testimi përfshin të gjitha lëndët dhe modulet e programit, duke reflektuar rëndësinë dhe peshën specifike të secilës në procesin akademik. Komisioni siguron një vlerësim objektiv, duke marrë parasysh përpjekjet dhe angazhimin e studentëve gjatë gjithë periudhës së studimeve. Provimi final synon gjithashtu të orientojë studentët drejt literaturës profesionale më të rëndësishme, kombëtare dhe ndërkombëtare, duke integruar problematika, teori dhe ide të debatuar në fushën shkencore. Përvetësimi i njohurive të programit vlerësohet përmes një testi me shkrim, i cili kombinon përmbajtjen akademike të leksioneve me kërkesat e programit. Ky detyrim përmbyllës përfaqëson 20% të vlerësimit të përgjithshëm të programit të studimit, duke ndikuar drejtpërdrejt në suksesin akademik të studentëve. <i>Evidenca 4.3 Rrregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.6 Syllabuset</i> <i>4.5.3 Plan i mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E (Tabela 9)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë	Personeli akademik, dhe në veçanti udhëheqësi i diplomës, ofron orientim dhe mbështetje të vazhdueshme për studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i diplomës ndihmon studentët në procesin e zgjedhjes së një teme të përshtatshme dhe relevante për fushën e studimit, duke siguruar që tema të jetë e qartë, e realizueshme dhe të kontribuoni në zhvillimin e njohurive shkencore dhe profesionale. Po ashtu, udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen dhe përpunimin e rezultateve kërkimore, si dhe në shkrimin e punimit përmbyllës në përputhje me udhëzuesit dhe standardet akademike të miratuara. Ai garanton cilësinë e punimit të diplomës duke inspektuar përmbajtjen dhe metodologjinë, dhe, përpara paraqitjes së punimit për komisionin, udhëheqësi miraton ose jo përfundimin e tij, duke siguruar që punimi është i plotë dhe i përshtatshëm për

për t'u paraqitur para komisionit.	shqyrtim. Ky proces mbështet një nivel të lartë të cilësisë dhe e siguron që studentët të përfundojnë punimin e diplomës në përputhje me standardet akademike. <i>Evidence 3.6 Rregullore për diplomat e ciklit II</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni ofron asistencë të plotë për studentët në kryerjen e matjeve, analizave në terren apo të dhënave të grumbulluara në forma të tjera kërkimore si brenda mjediseve të tij, ashtu edhe jashtë tij, në përputhje me temat dhe fushën e studimit. Ky mbështetje është e rëndësishme për realizimin e kërkimeve të sakta dhe të vlefshme, duke siguruar që studentët të kenë mundësi të aplikojnë njohuritë e tyre teorike në kontekste praktike dhe reale. Institucioni ofron mjetet e nevojshme dhe mundësitë për të realizuar këto aktivitete, si dhe siguron udhëzime për përdorimin e pajisjeve dhe teknologjive përkatëse. Kjo mbështetje ndihmon në zhvillimin e aftësive kërkimore dhe praktike të studentëve, duke i përgatitur ata për sfidat e fushës së studimit dhe karrierës profesionale. <i>Evidence 3.6 Rregullore për diplomat e ciklit II</i> <i>Evidenca 3.7 Raporti vjetor e Departamentit të Sociologjisë 2022-2023/2023-2024</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Referuar rVB, në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me note 4-10, duke reflektuar nivelin e njohurive dhe aftësive të studentëve të fituara gjatë programit të studimit. Ky vlerësim është një proces i strukturuar dhe i drejtë që pasqyron përgatitjen akademike dhe profesionale të studentit, duke marrë parasysh jo vetëm njohuritë teorike, por edhe aftësinë për t'i aplikuar ato në situata praktike dhe kërkimore. Vlerësimi me notë pas provimit përfundimtar ose mbrojtjes së punimit të diplomës ofron një reflektim të drejtpërdrejtë mbi performancën e studentit dhe është një pjesë kyçe e përmbylljes së procesit të studimeve, duke siguruar që studentët të arrijnë standardet e kërkuara për të marrë diplomën e studimeve të larta. <i>Evidenca 4.3 Rrregullore e programit të studimit</i> <i>Evidence 3.6 Rregullore për diplomat e ciklit II</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe	Pas përfundimit me sukses të studimeve dhe plotësimit të kërkesave akademike, përfshirë fitimin e krediteve të nevojshme dhe mbrojtjen e punimit të diplomës, studentët

suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	pajisen me diplomën dhe suplementin përkatës. Këto dokumente, të miratuara nga Ministria, lëshohen nga institucioni arsimor dhe përfaqësojnë dëshminë zyrtare të përfundimit të programit të studimit. Institucioni ruan një kopje të diplomës, ndërsa në rast humbjeje, studenti mund të pajiset vetëm me një vërtetim zyrtar të saj. <i>Evidenca 4.3 Rrregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.16 Model i diplomës</i> <i>Evidenca 4.17 Model suplementi i diplomës</i> <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018</i> <i>Evidenca 4.3 Rrregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni ruan dhe administron dokumentacionin e studentëve në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke siguruar ruajtjen e sigurt dhe konformitetin me normat ligjore dhe të privatësisë. Ky dokumentacion përfshin të dhëna të rëndësishme mbi përparimin akademik, provimet, diplomimin dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për proceset administrative. Në raste specifike, institucioni mund të ofrojë informacion mbi studentët, duke garantuar transparencë dhe respektimin e të drejtave të tyre. Dokumentacioni bazë për çdo student përfshin: ➤ Regjistrin themeltar të studentit, i cili dëshmon regjistrimin dhe pajisjen me numër matriculimi deri në përfundimin e studimeve dhe marrjen e diplomës ose certifikatës përkatëse. ➤ Regjistrin e arritjeve akademike, që pasqyron rezultatet dhe ecurinë akademike të studentit gjatë gjithë periudhës së studimeve. ➤ Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, i cili dokumenton dhënien e diplomave dhe certifikatave, duke garantuar saktësinë dhe integritetin e të dhënave. Kjo strukturë e dokumentimit siguron një menaxhim të rregullt dhe të besueshëm të informacionit akademik, duke mbrojtur të drejtat e studentëve dhe duke mundur një administrim efikas të të dhënave institucionale. <i>Evidenca 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018</i>
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson një administrim të rregullt dhe transparent të procesit akademik, nga vlerësimi i studentëve deri te</i>



	menaxhimi i dokumentacionit. Provimi final dhe mbrojtja e diplomës garantojnë një vlerësim të drejtë dhe gjithëpërfshirës, ndërsa ruajtja e të dhënave akademike siguron integritetin dhe besueshmërinë e informacionit. Këto standarde forcojnë cilësinë e arsimit dhe mbrojnë të drejtat e studentëve, duke mundësuar një sistem arsimor të strukturuar dhe të besueshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Njësia përgjegjëse siguron mjedise të përshtatshme për zhvillimin e programit Master Profesional “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”, duke mundësuar një lidhje të efektshme të mësimdhënies teorike dhe eksperiencës praktike. Fillimisht, studentët përfitojnë njohuri të avancuara në një ambient akademik të strukturuar, i cili u mundëson të thellojnë konceptet teorike. Më pas, praktikat profesionale zhvillohen në bashkëpunim me institucione dhe organizata të ndryshme jashtë mjediseve akademike, në përputhje me specifikat e programit. Praktika në institucione profesionale i ndihmon studentët të ndërveprojnë me tregun e punës dhe të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për karrierën e tyre. Ky model i integruar i mësimdhënies dhe praktikës profesionale garanton një përgatitje gjithëpërfshirëse, duke u mundësuar studentëve të aplikojnë njohuritë e fituara në situata reale dhe të jenë të gatshëm për sfidat e fushës së tyre profesionale. <i>Evidenca 2.28. Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16</i> <i>Evidenca 4.23 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe	Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet me organizata të tjera, garanton realizimin e praktikave profesionale duke i dhënë mundësi studentëve të aplikojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë studimeve në mjedise praktike të avancuara dhe të lidhura

stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më 63ire të njohurive dhe kompetencave profesionale.	ngushtë me zhvillimet e fundit në fushën e tyre profesionale. Praktikat janë të organizuara në mënyrë që studentët të përfitojnë sa më shumë nga eksperiencia e drejtpërdrejtë në terren, dhe për të zhvilluar kompetenca të larta profesionale. Kjo strategji ofron një mundësi për studentët që të përgatiten për sfidat e ardhshme profesionale dhe të rrisin aftësitë e tyre praktike përmes trajnimeve dhe eksperiencës të udhëhequr nga ekspertë të fushës. <i>Evidenca 4.23 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese</i> <i>Evidenca 4.23.1 Marrëveshje bashkëpunimi Fondacioni Zgjidhja e Konfliktëve</i> <i>Evidenca 4.23.2 Marrëveshje bashkëpunimi Dhoma kombëtare e Ndërmjetësve</i> <i>Evidenca 4.23.3 Marrëveshje bashkëpunimi me Odën e Ndërmjetësuesve Kosovë</i> <i>Evidenca 4.23.4 Marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Tiranë</i> <i>Evidenca 4.23.5 Marrëveshje bashkëpunimi me Universita' di Siena</i> <i>Evidenca 4.23.6 Marrëveshje bashkëpunimi me Shërbimin e Provës</i> <i>Evidenca 4.24 Raport analitik nga përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i>
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktikat profesionale gjatë programit të studimeve janë të ekuivaluara në kredite dhe dokumentohen në mënyrë të strukturuar, duke u shoqëruar me vlerësime nga mentorët. Ky proces siguron një pasqyrë të qartë dhe të drejtë të përvojës praktike, duke reflektuar ndikimin e saj në zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve. Praktika profesionale në programin Master Profesional “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” ekuivalentohet me 6 ECTS dhe vlerësohet me notë nga 4 në 10, nga personeli akademik që monitoron aktivitetin. Dokumentimi i këtyre praktikave siguron një pasqyrë të plotë dhe të verifikueshme të përvojës profesionale, e cila është thelbësore për zhvillimin e aftësive të studentëve dhe për arritjet e tyre akademike. <i>Evidenca 4.5.3 Plan i mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese A-E (Tabela 9)</i> <i>Evidenca 4.4 Korniza konceptuale e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.7 Manual i praktikës profesionale</i>
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se praktikat profesionale të programit Master Profesional “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”</i>

	sigurojnë një përvojë të balancuar dhe të strukturuar që mundëson zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve. Ekuivalenca e këtyre aktiviteteve me kredite (6 ECTS) dhe vlerësimi i qartë dhe objektiv nga trajnerët dhe mentorët, i ofron studentëve një pasqyrë të verifikueshme dhe të plotë të përvojës praktike, e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë në përfundimin e studimeve. Kjo qasje garanton një proces të drejtë dhe të vazhdueshëm vlerësimi, duke mbështetur cilësinë e praktikave profesionale dhe duke kontribuar në përgatitjen e studentëve për sfidat profesionale në fushën e zgjidhjes së konflikteve me ndërmjetësim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion konstaton se personeli efektiv, me kontratë i angazhuar në programin e studimit Master Profesional “Zgjidhje e Konflikteve me Ndërmjetësim”, është organizuar si në vijim:		
	Titulli/Grada	2022-2023	2023-2024

programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.		PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof.Dr.	1		1	
	Prof.As.	3		4	1
	Dr/PhD	4	1	1	2
	Dr në proces	-	-	-	-
	MsC	-	2		2
	TOTALI	8	3	6	5
Sipas përcaktimeve ligjore (pika 6 neni 59 i Ligjit Nr 80/2015), personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Nga sa më sipër konstatohet se në këtë program studimi Master Profesional, angazhohen edhe staf akademik me Msc (18 %). Për të mbuluar zhvillimin e tij, si një program edhe multidisiplinar, departamenti ka angazhuar edhe personel akademik efektiv, nga departmanetet e tjera, brenda njësisë kryesore, të cilët mbulojnë zhvillimin e programit. Ky personel ka fushë kërkimore në përputhje me natyrën e programit të studimit dhe veçoritë që programi paraqet. Departamenti ka rekrutuar personel të ri akademik. Personeli është rekrutuar sipas procedurës së parashikuar në nenin 64 e në vijim të Statutit të UT-së dhe Manualin mbi punësimin e personelit të Universitetit të Tiranës. <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018</i> <i>Evidenca 4.13 Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik Tabela 7</i> <i>Evidenca 4.15 CV e personelit akademik dhe ndihmës akademik për programin e studimit</i> <i>Evidenca 1.12 Manuali për punësimin e personelit në UT</i>					
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga analiza e informacionin të deklaruar në (evidencen 4.5.2 Plani mësimor i programit të studimit i lidhur me personelin akademik (Tabela 12), për ngarkesën mësimore të personelit akademik PAE dhe PAK rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është si më poshtë:				
	Viti Akdemik	PAE	PAK		
	2022-2023	91 %	9 %		

	2023-2024	84 %	16 %
	<u>Shënim:</u> Konstatohet mospërputhje e të dhënave të stafit mësimdhënës të programit sipas tabelave 6 dhe 12, ku në tabelat 12 deklarohet vetëm 1(2022-2023) dhe 2 (2023-2024) staf akademik me kontratë, ndërkohë në tabelat 6, 3(2022-2023) dhe 5 (2023-2024). Referuar nenit 51/b të Statutit të Universitetit të Tiranës, drejtuesi i departamentit mbikqyr shpërndarjen e ngarkesës mësimore të anëtarëve të njësive sipas drejtimeve të përcaktuara nga njësia dhe sigurohet për përmbushjen e saj. Ndarja e ndarkesës mësimore mes personelit akademik, realizohet në fillim të vitit akademik, duke respektuar normat e ngarkesës, shkallën e kualifikimit, eksperiencën e personelit akademik dhe numrin e grupeve për disipinat përkatëse. <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018</i> <i>Evidenca 4.26 Ngarkesa totale e personelit akademik (Tabela 4)</i> <i>Evidenca 4.13 Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik Tabela 7</i> <i>Evidenca 4.14 Ngarkesa totale (Tabela 13)</i> <i>4.5.2 Plani mësimor i programit të studimit i lidhur me personelin akademik (Tabela 12).</i>		
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	GVJ vëren se institucioni ka garantuar qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, nëpërmjet kontratave të reja të punësimit si dhe angazhimit të personelit efektiv nga departamentet e tjera. Për vitin akademik aktual, për ofrimin e programit të studimit, departamenti ka rekrutuar personel të ri akademik. Personeli është rekrutuar sipas procedurës së parashikuar në nenin 64 e në vijim të Statutit të UT-së dhe Manualin mbi punësimin e personelit të Universitetit të Tiranës. <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018</i> <i>Evidenca 4.13 Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik Tabela 7</i> <i>Evidenca 4.15 CV e personelit akademik dhe ndihmës akademik për programin e studimit</i> <i>Evidenca 1.12 Manuali për punësimin e personelit në UT</i>		
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në	Procedura e rekrutimit e ndjekur nga institucioni, mbështetet në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura. Punësimi në institucion, realizohet me procedurë konkurimi të hapur, duke		

kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv. Referuar nenit 67 të Statutit të UT, janë përcaktuar kriteret e përgjithshme të punësimit të personelit akademik, Njësia bazë, mbështetur në nevojat e saj, përcakton kriteret e veçanta shtesë, mbështetur mbi kategoritë e personelit që kërkohet të punësohet, të cilat miratohen nga Rektori. Shpallja e vendit të punës për personelin me kohë të plotë, bëhet në web faqet zyrtare por edhe në Buletinin e Njoftimeve të AAP. Drejtuesi i njësisë kryesore krijon një komision ad hoc për përgjedhjen e kandidatëve, të përbërë nga 5 anëtarë të kategorisë Prof. As. Dr, të cilët nuk duhet të kenë konflikt interesi. Referuar nenit 68 të Statutit të UT, për personelin me kohë të pjesshme, njësitë kryesore, me propozim të njësive bazë që kanë përcaktuar nevojat e tyre për personel jo efektiv, i kërkojnë Rektorit miratimin e kontratave të përkohshme për këtë kategori të personelit. <i>Evidenca 1.2 Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.12 Manuali për punësimin e personelit në UT</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Sipas GVJ, institucioni ka vënë në dispozicion mjedise mësimore të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Institucioni ka vënë në dispozicion salla apo mjedise të tjera të mësimdhënies, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për aftësim teorik dhe praktik, sipas objektivave formuese të programit të studimit. Institucioni ka garantuar angazhimin e një personeli ndihmës akademik (laborant) për ti ardhur në ndihmë personelit akademik për mbarëvajtjen e procesit mësimor. <i>Evidenca 2.28. Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16</i> <i>Evidenca 3.5 (1) Personeli efektiv PAE PAK Tabela 1</i> <i>Evidenca 3.5 (2) Personeli efektiv PAE PAK Tabela 2</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo	Referuar takimeve në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ konstaton se institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, përmes Degës së Burimeve Njerëzore dhe Protokoll/Arshivës në njësinë kryesore. Nëpërmjet aktit të titulluar “Udhëzim për dosjen e pedagogut”, janë përcaktuar elementët e përmbajtjes së saj, në formën e një dëshmie të dokumentuar të veprimtarisë së pedagogut, në katër aspekte kryesore, respektivisht në mësimdhënie, kërkim shkencor, kontribut institucional dhe kontribut profesional. Për personelet akademike me kontratë, pjesë e dosjes së personelit



anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	është dhe vlerësimi i tij/saj, me qëllim rinovimin ose jo të kontratës. <i>Evidenca 2.5. Struktura organizative e FSHS 2024</i> <i>Evidenca 2.18. Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit</i> <i>Evidenca 2.21. Udhëzim për dosjen e pedagogut</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ konstaton se institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme, për zhvillimin e praktikave mësimore. Marrëveshjet e bashkëpunimit për praktikat mësimore mundësohen me qëllim aftësimin praktik të studentëve në fushën e zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim. Studentët gjithashtu janë përfshirë në projekte të ndryshme, nëpërmjet bashkëpunimit me shoqatat respektive. Referuar edhe Manualit Udhëzues për praktikën profesionale, praktika, ka si qëllim krijimin e shprehive profesionale praktike tek studentët, nëpërmjet njohjes së drejtëpërdrejtë të punës në institucione të ndryshme që kanë si pjesë të tyre edhe menaxhimin e konfliktit dhe ndërmjetësimin. <i>Evidenca 4.7 Manual i praktikës profesionale</i> <i>Evidenca 4.23 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese</i> <i>Evidenca 4.24 Raport analitik nga përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	GVJ konstaton se referuar përmbushjes së detyrimeve sipas marrëveshjeve dhe dakordësisë për të zhvilluar praktikat mësimore, institucionet pritëse angazhohen në mënyrë specifike për të ndihmuar studentët në përmbushjen e detyrimeve dhe marrin pjesë në procesin e vlerësimit të praktikës. Në përfundim të periudhës së praktikës, referuar Manualit Udhëzues për praktikën profesionale, studenti duhet të dorëzojë Raportin e përgatitur nga personi mbikqyrës i institucionit ku ka kryer praktikën, sipas formatit standard të hartuar nga Departamenti i Sociologjisë si dhe raportin e përgatitur nga studenti sipas formatit të hartuar nga Departamenti i Sociologjisë. <i>Evidenca 4.7 Manual i praktikës profesionale</i>
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se personeli akademik dhe ndihmës akademik i angazhuar për realizimin e programit të studimit Master</i>

	<i>Profesional "Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim", I përmbush kryesisht kriteret ligjore në fuqi, duke patur nivelin e duhur të kualifikimit, mbulimin e ngarkesës mësimore. Institucioni dëshmon qëndrueshmëri të personelit të angazhuar. Gjithashtu procedura e ndjekur për rekrutimin realizohet me procedurë konkurimi të hapur, duke garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv, në përgjigje të nevojave specifike të njësisë. Të dhënat në lidhje me personelin mbledhen, ruhen dhe përditësohen nga Zyra/Dega e Burimeve Njerëzore</i> <i>GVJ rekomandon që, Institucioni në këtë program studimi, të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ vlerëson se gjatë vizitës në institucion, fakulteti ka siguruar mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Këto mjediset janë vënë në dispozicion bazuar në numrin e studentëve dhe grupeve mësimore. Në referim të studentëve të regjistruar në program studimi dhe programit të lëndës, oraret dhe sallat e leksioneve dhe seminareve afishohen. Aktualisht godina është në proces rikonstruksioni (katet e sipërme) pasi po i shtohen dhe ambiente të dedikuara për bibliotekën. Fakulteti plotëson normativën e ndriçimit natyral, siguron ngrohje dhe ftohje në të gjithë godinën, si dhe përmbush detyrimet për sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit. <i>Evidenca 2.28. Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16</i> <i>Evidenca 2.29. Raporti i ekspertit për infrastrukturën</i>

Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore të vëna në dispozicion për programin e studimit, janë të pajisura me mjete elektrike dhe teknologjike për të mundësuar një proces teorik e praktik sipas metodave metodologjike bashkëkohore të mësimdhënies e mësimnxënies, ku disa salla janë të pajisura edhe me tabelat inteligjente (smart boards). Një kujdes i posaçësm i mundësohet studentëve me aftësi ndryshe, ku në dispozicion të tyre janë vënë rampa dhe ashensorë apo sinjalistikën e nevojshme, që mundësojnë lëvizjen e lirë e pa problem të tyre. <i>Evidenca 2.28.Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16</i> <i>Evidenca 2.29.Raporti i ekspertit për infrastrukturën</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimi teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në Fakultetin e Shkencave Sociale, ambientet e dedikura për procesin mësimor, plotësojnë kushtet për mësimdhënie. Ato janë të pajisura me infrastrukturën e përfshatshme teknologjike, për plotësimin e kërkesave të moduleve dhe objektivave formuese të programit. Fakulteti ofron një sallë interneti (në bibliotekën e sotme, e emërtuar salla multimediale, me 8 kompjutera për student), e cila ka poste të pajisura me teknologjinë e nevojshme, dhe mund të shfrytëzohen nga studentët edhe jashtë orarit të mësimi, për realizimin e detyrave praktike, si edhe një ambient të dedikuar për fotokopjime dhe librari. <i>Evidenca 2.28.Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16</i> <i>Evidenca 2.29.Raporti i ekspertit për infrastrukturën</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	GVJ konstaton se në Fakultetin e Shkencave Sociale, aktualisht nuk ka një laborator të dedikuar të teknologjisë së informacionit. Fakulteti ofron një sallë interneti (në bibliotekën e sotme, e emërtuar salla multimediale, me 8 kompjutera për student), e cila ka poste të pajisura me teknologjinë e nevojshme, dhe mund të shfrytëzohen nga studentët edhe jashtë orarit të mësimi, për realizimin e detyrave praktike. Vlen të theksohet se godina është në proces rikonstruksioni dhe do të ketë një riorganizim të strukturave. <i>Evidenca 2.28.Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16</i> <i>Evidenca 2.29.Raporti i ekspertit për infrastrukturën</i>




Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.	Gjatë takimeve në institucion, u konstatua se fakulteti, për programin e studimit Master Profesional në “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme. Marrëveshjet e bashkëpunimit për praktikat mësimore mundësohen me qëllim aftësimin praktik të studentëve. Kjo marrëdhënie është e rregulluar edhe nëpërmjet udhëzimit për zhvillimin e praktikave dhe formularët e praktikës mësimore. <i>Evidenca 4.23 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese</i> <i>Evidenca 4.24 Raport analitik nga përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i> <i>Evidenca 4.7 Manual i praktikës profesionale</i>			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se Fakulteti i Shkencave Sociale ka vënë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit të mësimdhënies për programin e studimit.</i> <i>Aktualisht godina është në proces rikonstruksioni, por vlen të përmendet se përmbush normativën e sipërfaqes dhe vëllimin e shfrytëzueshëm për studentët, plotëson normativat e ndriçimit natyral, ajrosjes, ngrohjes apo ftohjes në të gjithë godinën dhe siguron sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit. Institucioni ka krijuar lehtësira infrastrukturore për studentët me aftësi ndryshe. Institucioni mundëson nëpërmjet implementimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit, zhvillimin e praktikave mësimore, sipas manualit përkatës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ vlerëson se Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Sociale, në gjëndjen aktuale, i mundëson studentëve aksesin në fondin e saj fizik dhe digjital. Literatura bazë dhe ndihmëse, u prezantohet studentëve në silabuset e lëndëve. Fondi i bibliotekës është pasuruar vazhdimisht, <i>edhe pse botimet nuk i përkasin viteve të fundit.</i> <i>Evidenca 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17</i> <i>Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën</i> <i>Evidenca 2.26. Buxhetimi për pasurim të bibliotekës</i> <i>Evidenca 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ konstaton se literatura e vënë në dispozicion për programin e studimit, i korrespondon një literature jo të viteve të fundit. Gjatë vizitave në institucion u theksua se literature pasurohet në mënyrë të vazhdueshme, gjatë zhvillimit të lëndës, duke bërë pjesë të saj edhe raporte apo jurisrudencë. Për studentët dhe personelin është vënë në dispozicion biblioteka online. Gjithashtu institucioni ka një praktikë të pasurimit të fondit të bibliotekës, sipas kërkesave të njësive bazë, para fillimit të vitit akademik. <i>Evidenca Silabuset e lëndëve</i> <i>Evidenca 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17</i> <i>Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën</i> <i>Evidenca 2.26. Buxhetimi për pasurim të bibliotekës</i> <i>Evidenca 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion, u konstatua se fakulteti ka vënë në dispozicion të ambientet e bibliotekës, dy sallat respektive, respektivisht një sallë multimediale e pajisur me PC dhe një sallë leximi për studentët ku aksesohet edhe fondi i librit. Marrëdhënia e studentëve apo personelit me bibliotekën, rregullohet me një akt të veçantë. Vlen të theksohet se aktualisht

	godina është në proces rikonstruksioni (katet e sipërme) pasi po i shtohen dhe ambiente të dedikuara për bibliotekën. <i>Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën</i> <i>Evidenca 2.24. Rregullore e Bibliotekës 2019</i> <i>Evidenca 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën</i> <i>Evidenca 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e institucionit është në dispozicion të gjithë programeve të studimit që ofrohen. GVJ konfirmon se biblioteka është e pajisur me fond fizik si tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse, kryesisht në gjuhën shqipe. Fondi i bibliotekës përbëhet nga blerjet dhe dhurimet e materialeve. Aksesit në artikuj e revista shkencore, realizohet përmes bibliotekës elektronike, sipas adresave të dedikuara institucionale. Informatizimi i bibliotekës është bërë sipas sistemit të katalogimit cobiss. Pjesë e fondit të bibliotekës, janë edhe punimet e diplomave të studentëve apo proceeding books të konferencave të organizuara. Biblioteka vetëpasurohet në mënyrë të vazhdueshme falë edhe publikimit të revistave shkencore “Politikja” dhe “Puna Sociale dhe Politika Sociale”. <i>Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën</i> <i>Evidenca 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën</i> <i>Evidenca 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Aktualisht, fondi i literaturës elektronike të institucionit është i ofruar për të gjithë studentët në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë. Aksesit garantohej edhe jashtë ambienteve të institucionit, duke përdorur logimin me kredencialet institucionale, të cilët studentët mund ti përdorin në bibliotekë, në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë. <i>Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën</i> <i>Evidenca 2.24. Rregullore e Bibliotekës 2019</i> <i>Evidenca 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën</i> <i>Evidenca 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë	Gjatë vizitës në institucion u vërejt se ambientet e bibliotekës (salla multimediale) janë të pajisur me kompjutera dhe programe kompjuterike që mundësojnë shfrytëzimin e tyre. Studentët ambientet e bibliotekës i shfrytësojnë edhe si salla studimi, duke

shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	qenë se janë në dispozicion të të gjithë studentëve të insitucionit dhe asistohen nga personel i dedikuar. <i>Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën</i> <i>Evidenca 2.24. Rregullore e Bibliotekës 2019</i> <i>Evidenca 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën</i> <i>Evidenca 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Nga takimi me studentët si dhe gjatë vizitës në institucion u konstatua se biblioteka është në dispozicion të studentëve, sipas orareve të koordinuara të zhvillimit të procesit mësimor dhe janë të afishuara. <i>Evidenca 2.24. Rregullore e Bibliotekës 2019</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Nga takimet e zhvilluara në insitucion dhe gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës, u vu re se duhet të ketë një koordinim dhe bashkëpunim për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës, i cili jo vetëm duhet ti përgjigjet një literature të përditësuar të viteve të fundit, por dhe të ketë një numër kopjesh të mjaftueshme për programin e studimit. Në aktet e brendshme të institucionit, studentët informohen me të drejtat dhe detyrimet e tyre mbi aksesin në bibliotekë. Pasurimi i fondit të bibliotekës bëhet përmes blerjes së librave (sipas kërkesës së departamentit), dhurimeve dhe abonimeve në biblioteka digjitale apo revista shkencore. <i>Evidenca 3.17 Propozim për blerje librash DS</i> <i>Evidenca 3.14 Buxhet i konsoliduar i Departamentit të Sociologjisë 2023, 2024</i> <i>Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën</i> <i>Evidenca 2.24. Rregullore e Bibliotekës 2019</i> <i>Evidenca 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën</i> <i>Evidenca 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17</i>
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se Fakulteti i Shkencave Sociale ka vënë në</i>

	dispozicion të studentëve dhe stafit bibliotekën, si një ambient të dedikuar, të pajisur me tavolina pune, kompjutera dhe rafta librash. Biblioteka përbëhet nga fond fizik (i blerë apo i dhuruar) dhe elektronik si dhe nga aksesit në burime të jashtme, në formën e bibliotekës digjitale. Biblioteka aksesohet e koordinuar me oraret e procesit mësimor, aksesohet dhe në çdo kohë fondi elektronik i saj, përmes adresave zyrtare. Biblioteka ka një personel të dedikuar. Literatura e lëndës pasurohet në orën mësimore me raporte, artikuj dhe vendime të jurisprudencës sipas rastit, por duhet edhe të përditësohet me literaturën respektive të viteve të fundit, si pjesë e sylabuseve të lëndëve (literature e detyruar), por edhe fondit të bibliotekës. Aktualisht, Godina e Fakultetit është në process rikonstruksioni, ku një kat i është dedikuar riorganizimit të ambienteve të bibliotekës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ konstaton se sistemi i menaxhimit dhe administrimit të informacionit lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre, realizohet përmes sekretarisë mësimore të programit të studimit të ciklit të dytë. Të dhënat administrohen në format fizik dhe elektronik përmes regjistrave përkatës. Studentët aksesojnë informacionin e nevojshëm për mbarëvajtjen akademike (orari, lëndët, notat) përmes platformës së dedikuar e-student. <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018</i> <i>Evidenca 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018</i> <i>Evidenca 1.10. Manual përdorimi i sistemit informatik e-student 2022</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit	Pas vizitës dhe takimeve të kryera në institucion, u vë re se sistemi i brendshëm i menaxhimit dhe administrimit të

administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	informacionit, realizohet sipas strukturave të përcaktuara në aktet e brendshme të institucionit. Respektivisht, informacioni që lidhet me dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, ndahet midis njësisë bazë dhe zyrës së burimeve njerëzore, e cila është përgjegjëse për ruajtjen dhe përditësimin e dosjes së personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrative të angazhuar. Në nivel njësie kryesore, përmes koordinаторit të programit, realizohet mbledhja, përpunimi dhe administrimi i dokumentacionit që lidhet me veprimtarinë e tij. Në të dyja këto nivele, dokumentacioni ruhet në format hard copy dhe elektronik. Për procesin mësimor, asiston në menaxhimin dhe administrimin e informacionit sekretaria mësimore. <i>Evidenca 1.2.Statuti 2018</i> <i>Evidenca 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 4.18 Vendim për caktimin e koordinatorit</i> <i>Evidenca 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018</i> <i>Evidenca 1.10. Manual perdorimi i sistemit informatik e-student 2022</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni, sistemin e menaxhimit elektronik e ka të organizuar në dy nivele. Së pari, nivelin e personelit (ku përfshin personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ) dhe së dyti niveli i studentit. Niveli i personelit mundëson administrimin, siguron akses të dedikuar në informacione që lidhen me procesin mësimor dhe dokumentet e gjeneruara respektive, si prsh procesverbalet e vlerësimit. Ndërkohë për studentët, përmes e-student mundësohet akses në materialet e leksioneve, literatures dhe në të gjitha zërat e programit të studimit, informacion që lidhet me lëndët, kreditet, mënyrën e vlerësimit etj. <i>Evidenca 1.10. Manual perdorimi i sistemit informatik e-student 2022</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Referuar takimeve të zhvilluara në institucion, mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit elektronik, vërehet se është kryesisht një komunikim pasiv, me qëllim shkëmbimin e informacionit, mes dy niveleve të përfshirjes së tij, personelit dhe studentëve. Efikasiteti i sistemit të menaxhimit konsiston në mundësinë e aksesit të informacionit në çdo kohë apo vend.

	<i>Evidenca 1.10. Manual perdorimi i sistemit informatik e-student 2022</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ konstaton se sistemi i menaxhimit elektronik por dhe ai jo elektronik në institucion, ndihmon në monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik të personelit përgjegjës, për element që lidhen me procesin mësimor, kërkimin shkencor etj. Gjithashtu mundëson prodhimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore që lidhen me performancën e studentit apo frekuentimin. Gjithashtu të dhënat e mbledhura mundësojnë gjenerimin e raporteve vjetore institucionale që u vihen në dispozicion organeve drejtuese, për procese strategjike të institucionit apo për procese të ndryshme institucionale.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Universiteti i Tiranës ka një faqe website zyrtare, në të cilën publikohen në dy gjuhë informacionet lidhur me programin e studimit, personelin, aktivitetet etj. Referuar takimeve në fakultet por edhe dokumentacionit shtesë të paraqitur, faqja web për Fakultetin e Shkencave Sociale është duke iu nënshtruar procesit të përditësimit të saj. <i>Evidenca extra nr. 5. Përditësim i Webit FSHS</i>			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se Fakulteti i Shkencave Sociale ka krijuar një sistem të brendshëm funksional të menaxhimit, administrimit dhe publikimit të informacionit. Kjo është realizuar përmes akteve të brendshme të institucionit sipas të cilave janë përshkruar detyrat dhe funksionet respektive përsa i përket mënyrës së administrimit të informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik apo financiar në nivel institucioni, njësie kryesore edhe njësie bazë.</i> <i>Gjithashtu, institucioni ka ngritur një platformë elektronike e-student, në dispozicion të personelit dhe studentëve, si një formë e mbajtjes, ruajtjes dhe administrimit të të dhënave që lidhen me procesin mësimor, kryesisht me lëndën, leksionet, prezencën, vlerësimet etj. Fakulteti aktualisht është duke përditësuar faqen Web.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve të realizuara, GVJ konstaton se institucioni ka një procedurë të mirëpërcaktuar të planifikimit dhe përdorimit të burimeve financiare. Planifikimi konsiston tek përcaktimi i nevojave financiare të njësisë bazë për realizimin e programit të studimit e përfundon tek miratimi i tyre nga Bordi i Administrimit. Administratori i fakultetit harton çdo vit projekt buxhetin sipas kërkesave të njësive përbërëse. Raportet financiare diskutohen në dekanat e më pas i përcillen Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të Universitetit të Tiranës. Ndryshimet e mundshme të buxhetit të institucionit bëhen sipas procedurave të parashikuara në aktet e brendshme. <i>Evidenca 1.2.Statuti 2018</i> <i>Evidenca 2.30.Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, per FSHS (Tabela 18)</i> <i>Evidenca 2.32.Buxheti afatmesëm FSHS 2022-2025</i> <i>Evidenca 2.33.Buxheti i FSHS 2023</i>

Kriteri 2.Plani i financimit të njësishë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të	GVJ konstaton se raporti i hollësishëm financiar përgatitet nga Administratori i fakultetit. Raporti përmban detyrimet financiare, pagat, shpenzimet si dhe të ardhurat e përfituara nga kontratat për Kërkim dhe Zhvillim apo projekte ku njësia është pjesë. <i>Evidenca 2.30.Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, per FSHS (Tabela 18)</i> <i>Evidenca 2.32.Buxheti afatmesëm FSHS 2022-2025</i> <i>Evidenca 2.33.Buxheti i FSHS 2023</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	GVJ vlerëson se në zbatim të politikës së transparencës në përdorimin e burimeve financiare, kryhet një auditim i përvitshëm, për të vlerësuar dhe dokumentuar gjendjen financiare. Auditimi kryhet nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të Universitetit të Tiranës, ku në përfundim të procesit lihen edhe rekomandimet përkatëse. Raporti financiar auditues, nuk përmban vetëm pasqyrat e gjendjes financiare por edhe shpërndarjen e burimeve financiare. <i>Evidenca 2.34.Raport auditit FSHS</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësishë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Në Fakultetin e Shkencave Sociale, Administratori i Fakultetit raporton deri në nivel njësie bazë për realizimin e buxhetit të miratuar të vitit pasardhës. Realizimi i buxhetit bëhet edhe pjesë e analizës vjetore të njësishë si dhe monitorohet nga procesi i auditimit të brendshëm. <i>Evidenca 2.16.Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023</i> <i>Evidenca 2.30.Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, per FSHS (Tabela 18)</i> <i>Evidenca 2.32.Buxheti afatmesëm FSHS 2022-2025</i> <i>Evidenca 2.33.Buxheti i FSHS 2023</i>




Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Pas vizitës në institucion dhe takimeve të zhvilluar, GVJ vëren se institucioni garanton qëndrueshmëri financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit Master Profesional “Zgjidhje e konflikteve me Ndërmjetësim”. Institucioni ka kapacitete infrastrukturore dhe burime njerëzore të mjaftueshme për realizimin e tij. Pasqyrat financiare pasqyrojnë qëndrueshmërinë dhe gjendjen financiare të institucionit për garantimin e vazhdimin dhe ecurinë e programit në të ardhmen. <i>Evidenca 2.30. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, per FSHS (Tabela 18)</i>
--	---

Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se institucioni, përmes strukturave të tij realizon planifikimin financiar të njësisë kryesore, përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit. Planifikimi realizohet përmes identifikimit të nevojave, të cilat më pas bëhen pjesë e buxhetit vjetor dhe afatmesëm të institucionit. Nevojat përfshijnë ato infrastrukturore, kërkimore shkencore apo didaktike.</i> <i>Institucioni realizon në mënyrë periodike procesin e auditimit të brendshëm, përmes Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, pjesë e Universitetit të Tiranës. Pasqyrat financiare reflektojnë qëndrueshmërinë dhe gjendjen financiare të institucionit, si një garanci për vazhdimin e programit në të ardhmen.</i>			
--------------------	--	--	--	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një paketë aktesh të brendshme të cilat normojnë dhe rregullojnë procesin e pranimin, ndjekjes dhe diplomimit të studentëve, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Studentët kanë mundësi të aksesojnë këtë bazë ligjore, në kohën që ndjekin studimet pranë këtij institucioni. <i>Evidenca 1.2.Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 1.4. Strategjia-e-Zhvillimit-e-Universitetit-te-Tiranes-2023-2028</i> <i>Evidenca 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 1.21. Vendim SA nr.7 dt 13.03.2024 me kuotat cikli II 2024-2025</i> <i>Evidenca 2.11.Rregullore e Diplomimit FSHS</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ vëren se sipas akteve të brendshme të institucionit, janë parashikuar politika dhe procedura që garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student në programin e studimit. Këtë program studimi mund ta ndjekin studentë nga universitetet shqiptare (publike apo private) si dhe studentë nga vendet shqipfolëse, të cilët zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS. Departamenti ngre një komision ad hoc, për shqyrtimin dhe renditjen e fituesve në programin e studimit. <i>Evidenca 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.22 Mbi miratimin e komisionit të shqyrtimit të dosjeve</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti	GVJ konstaton se pranimet në ciklin e dytë të studimeve bëhen në përputhje me specifikat e programit të studimit, nevojat e

akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	tregut, mundësitë akademike dhe infrastrukturore të institucionit. Institucioni shpall kriteret specifike të pranimit në programin e studimit (të publikura në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës dhe atë të Fakultetit të Shkencave Sociale), ku mund ta ndjekin studentë nga universitetet shqiptare (publike apo private) si dhe studentë nga vendet shqipfolëse, të cilët zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS. Aktet e brendshme të institucionit, parashikojnë procedurat dhe afatet lidhur me procedurat e pranimit, kriteret e transferimit apo njohja e studimeve dhe studentët vihen në dijeni përmes sekretarisë mësimore, në rast pyetjesh apo paqartësish. <i>Evidenca 1.2.Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 1.21. Vendim SA nr.7 dt 13.03.2024 me kuotat cikli II 2024-2025</i> <i>Evidenca 2.11.Rregullore e Diplomimit FSHS</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Referuar akteve të brendshme të institucionit, janë parashikuar kriteret dhe procedura e pranimit apo transferimit, ku ky i fundit mund të realizohet vetëm para fillimit të vitit akademik. Aktet e brendshme të institucionit i prezantohen studentëve nga personeli akademik dhe përgjegjësi i departamentit, në fillimin e vitit akademik. Në rast pyetjesh apo paqartësish, studentët asistohen nga sekretaria mësimore. Kriteret e pranimit miratohen me vendim të Senatit Akademik dhe publikohen në faqen zyrtare web të institucionit. <i>Evidenca 1.2.Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 1.21. Vendim SA nr.7 dt 13.03.2024 me kuotat cikli II 2024-2025</i> <i>Evidenca 4.21 Shkresa Mbi miratimin e kriterëve të pranimit</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik,	GVJ gjatë vizitave në institucion konstaton se institucioni informon publikun dhe të interesuarit për kriteret e pranimit në

institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	programin e studimit. Referuar dokumentit të politikave të marketingut, kanalet më të shpeshta të promovimit janë postimet në faqen zyrtare të Universitetit, pjesëmarrja në panairë, llogaritë institucionale të rrjeteve sociale si dhe organizimi i konferencave apo veprimtarive të tjera shkencore. Institucioni ka emetuar dhe shpërndan broshura informuese. <i>Evidenca 3.9 Politika marketing</i> <i>Evidenca 3.10 Broshurë informative</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore, ka kuota të dedikuara për kandidatët me aftësi të veçanta, pakicave apo shtresave të marginalizuara. Për studentët me aftësi ndryshe institucioni mundëson përdorimin e mjediseve përmes marrjes së masave specifike si materiale të aksesueshme të përshtatshme. Personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ është i angazhuar për t'u dhënë ndihmën dhe kujdesin e nevojshëm studentëve me aftësi ndryshe, për mbarëvajtjen e procesit mësimor. <i>Evidenca 1.2.Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 1.21. Vendim SA nr.7 dt 13.03.2024 me kuotat cikli II 2024-2025</i> <i>Evidenca 4.21 Shkresa Mbi miratimin e kriterëve të pranimit</i> <i>Evidenca 4.25 Evidencë për regjistrimin e studentëve nga trojet</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ vlerëson se institucioni shpall kriteret specifike të pranimit në programin e studimit, studentë nga shtetet e tjera shqipfolëse, të cilët zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS. <i>Evidenca 4.21 Shkresa Mbi miratimin e kriterëve të pranimit</i> <i>Evidenca 4.25 Evidencë për regjistrimin e studentëve nga trojet</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ pas takimeve të zhvilluara në institucion vë re se insitucioni ofron mundësi të pajisjes së studentëve me bursa apo reduktim të tarifave sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se institucioni, ka hartuar dhe zbaton politika të mirëpërcaktuara në aktet e brendshme, për procedurat e pranimit, përzgjedhjes, transferimin njohejn dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Këto politika fillojnë që në momentin e regjistrimit në institucion e përfundojnë pasi studenti diplomohet.</i> <i>Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve publikohen në faqen web të institucionit dhe janë të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku dhe të interesuarit. Institucioni përmes fushatave informuese apo pjesëmarrjes në panairë prezanton ofertën akademike.</i> <i>Një praktikë shumë e vlerësuar, është hartimi i dokumentit për politikat e marketingut, por që aktualisht nuk ka prodhur rezultatet e pritura, pasi për vitin akademik aktual, nuk ka studentë të regjistruar. Institucioni nxit dhe mbështet studentët me anë të bursave dhe reduktimin e tarifave sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ vëren se institucioni ofron një informacion të plotë dhe të hollësishëm për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik. Në aktet e brendshme është parashikuar se programi i studimit realizohet me ndjekje mësimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje 1 vit, ku në përfundim të tij studenti plotëson 60 kredite. Format kryesore të punës mësimore janë leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat mësimore, detyrat, projektet dhe provimet. Orët mësimore janë me frekuentim të detyrueshëm. Shkalla e përvetësimit të dijeve vlerësohet me një sistem prej 10 notash, ku nota 5 e lart, konsiderohen nota kaluese.




	Nëse studenti nuk plotëson detyrimet akademike të përcaktuara në programin e lëndës, ai nuk pranohet në provim. Ndër të tjera, studenti ka të drejtë të zgjasë afatin e studimeve mbi kohën normale, por jo më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes respektive. Në përfundim të këtij cikli studimesh, studentët kanë të drejtë të diplomohen, me anë të temës së diplomës apo provim formimi dhe pajisen me diplomë Master Profesional në “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”. <i>Evidenca 1.3. rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 1.21. Vendim SA nr.7 dt 13.03.2024 me kuotat cikli II 2024-2025</i> <i>Evidenca 2.11.Rregullore e Diplomimit FSHS</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.16 Model i diplomës</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ vlerëson së sekretaria mësimore informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme, sipas interesimit të tyre. Informacioni ndodhet edhe i publikuar në faqen web të institucionit. <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Pas takimeve të zhvilluara në institucion, GVJ vlerëson se institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Kjo procedurë realizohet në fillim të vitit akademik, ku secili personel akademik shpjegon përmes silabusit të lëndës, këto kriteret. Gjithashtu procesi i informimit shtrihet gjatë vitit akademik duke u interesuar pranë lektorit përkatës apo edhe sekretarisë mësimore. <i>Evidenca 1.3. Rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca mbi silabuset e lëndëve</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me	GVJ konstaton se institucioni ka hartuar dhe zbaton një rregullore për diplomat e ciklit të dytë të studimeve. Dokumenti përmban shpjegime në lidhje me zgjedhjen dhe miratimin e




kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	temës, mënyrën e zhvillimit të udhëheqjes së punimit të diplomës, zhvillimin e seancave këshillimore, dhe mënyrën e organizimit të punimit të diplomës. Procesi i fundit është vlerësimi u punimit nga komisioni i vlerësimit dhe kriteret mbi ku bazohen. <i>Evidenca 3.6 Rregullore për diplomat e ciklit II</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ vlerëson se institucioni realizon para fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike informimin e të interesuarve për programin e studimit. Kjo realizohet përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës, e cila koordinon punën për pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme promovuese apo panaire. Institucioni ka prodhuar dhe vë në dispozicion të të interesuarve broshura informuese. <i>Evidenca 2.22.Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021</i> <i>Evidenca 3.9 Politika marketing</i> <i>Evidenca 3.10 Broshurë informative</i>			
Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se institucioni, vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen dhe vlerësimin e dijeve deri në diplomimin e tyre. Për sa më lart institucioni ka hartuar një paketë të plotë të akteve të brendshme që shpjegojnë dhe detajojnë këto marrëdhënie. Aktet u bëhen me dijeni dhe janë të aksesueshme nga studentët. Institucioni i arsimit të lartë organizon dhe merr pjesë në formate promovimi të programeve të studimit që ofron, për t'ia bërë me dijeni studentëve potencialë dhe komunitetit. Institucioni ka detajuar kriteret e pranimit si dhe procedurat e transferimit të studimeve. Për studentët, vihet në dispozicion një rregullore për punimin e diplomës, i cili orienton dhe strukturon studentët drejt finalizimit me sukses të saj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Gjatë takimit me studentët, GVJ vlerësoi se ata informoheshin në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Në fillim të çdo viti akademik, studentët informohen dhe u prezantohet silabusi nga lektori përgjegjës. Gjithashtu procesi i informimit shtrihet gjatë vitit akademik duke u interesuar pranë lektorit përkatës apo edhe sekretarisë mësimore. Informacioni si orari apo njoftime të ndryshme shfaqen në monitorët informues në ambientet e koridoreve të Fakultetit të Shkencave Sociale. <i>Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 4.3 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca mbi silabuset e lëndëve</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ vlerëson se studentëve, institucioni i vë në dispozicion dokumentacion dhe udhëzues të posaçëm për lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Departamenti i Sociologjisë në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës, organizon takime informuese me studentët duke i informuar mbi strukturat apo shërbimet që institucioni ofron. <i>Evidenca 2.22.Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Gjatë takimeve në institucion, studentët dhe personeli akademik konfirmoi se një pjesë e mirë e studentëve që ndjekin programin e studimit, janë aktualisht në një marrëdhënie pune. Megjithatë përmes zyrës së Këshillimit të Karrierës, studentët informohen mbi mundësitë e punësimit, trajnime apo intershipte apo organizon trajnime për të realizuar aplikime të suksesshme në punë. <i>Evidenca 2.22.Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021</i> <i>Evidencë extra Evidenca nr. 9. Plani i punes 2024-2025 Karriera (1)</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për	GVJ vëren se institucioni iu vë studentëve në dispozicion një informacion të gjerë dhe të përditësuar për zhvillimin e procesit mësimor. Studentët informohen nga personeli akademik për





zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	çështje që lidhen me procesin mësimor dhe informohen nga sekretaria mësimore për informacione që lidhen me administrimin e procesit mësimor. Në korridoret e fakultetit gjenden ekrane ku publikohen informacione të ndryshme si orari mësimor, orare të provimeve apo njoftime të ndryshme. <i>Evidenca 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Studentët dhe personeli akademik, në takimet e realizuara me GVJ kanë theksuar zbatimin e një politike “me dyer të hapura”, ku studentët kanë mundësinë të kenë akses në informacion por edhe të mirëinformohen për procese, procedura dhe elementë të tjerë të rëndësishëm për procesin mësimor. Në ndihmë të këtij procesi vinë edhe strukturat e sekretarisë mësimore, zyrës së informacionit dhe zyrës së këshillimit të karrierës. <i>Evidenca 2.22. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021</i> <i>Evidencë extra Evidenca nr. 9. Plan i punes 2024-2025 Karriera (I)</i> <i>Evidenca 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018</i>			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se institucioni, vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të hollësishëm mbi objektivat formuese, strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit. Një rol shumë të rëndësishëm në këtë pjesë ka personeli akademik.</i> <i>Përmes strukturave ndihmës akademike si sekretaria mësimore, zyra e informacionit apo këshillimi i karrierës, studentët informohen mbi problematikat e tyre si edhe mundësitë e punësimit dhe orientimin në tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------




Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ konstatoi se Sekretaria Mësimore e Fakultetit mban dhe përpunon të dhëna statistikore vjetore lidhur me numrin e studentëve në programin e studimit Master Profesional në “Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim” si dhe të dhëna statistikore lidhur me studentët e diplomuar. <i>Evidenca 1.3. rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Përmes sekretarisë mësimore, institucioni siguron të këtë disponim mbi statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, tërheqjet nga programi, largimet, pezullimet etj. Sekretaria mësimore disponon dhe administron regjistrat e posaçëm. Të dhënat e disponuara përditësohen dhe përpunohen, sipas proceve institucionale dhe raportimeve të ndryshme. Referuar shqyrtimit të dokumentacionit numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është si më poshtë vijon: Viti akademik 2022-2023 13 studentë; Viti akademik 2023-2024 11 studentë; <i>Evidenca 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018</i> <i>Evidenca 4.10 Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21)</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ vëren se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen në dy forma. Në formatin hard copy dhe regjistrave respektivë si dhe në format elektronik, përmes portalit e-student. Të dhënat i nënshtohen legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tyre. Gjithashtu saktësia e të dhënave mundëson verifikimin e tyre në çdo kohë nga persona të autorizuar. <i>Evidenca 1.8. Rregullore UT për “Mbrojtjen, Përpunimin, ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave personale</i> <i>Evidenca 1.10. Manual përdorimi i sistemit informatik e-student 2022</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit,	Bazuar në aktet e brendshme, institucioni mbështet kontrollin periodik të njësive, nëpërmjet analizës vjetore të punës. Ndërkohë institucioni nuk ka paraqitur një raport të mënyrës sesi vlerësohet dokumentimi i gjendjes dhe saktësisë së informacionit. I vetmi vlerësim periodik me në fokus studentët, është ai i relaizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të

etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Cilësisë, ku matet periodikisht vlerësimi i studentëve, në nivel njësie bazë, kryesore dhe institucionale në tërësi. <i>Evidenca 1.7. Rregullore per vleresimin e performances ne pune personel ndihmes akademik dhe administrative</i> <i>Evidenca 2.17.Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca 2.16.Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023</i> <i>Evidenca ekstra Evidenca nr. 9. Plane pune NJSBC</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	GVJ vlerëson se njësia bazë, në analizën vjetore në saj, duhet të hartojë dhe paraqesë raporte periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Hartimi i raporteve analitike, duke matur cilësinë e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar, mundëson marrëjen e masave respektive, për përmirësimin e programit të studimit apo kushteve të pranimit, duke realizuar edhe punësimin e tyre apo rrijen e cilësisë së atudentëve të pranuar. Sot kjo procedurë realizohet nga sekretaria mësimore, duke u fokusuar kryesisht në përpunimin e të dhënave në formë sasiore dhe jo duke u ndalur në analiza cilësore të nevojshme. <i>Evidenca 2.16.Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023</i> <i>Evidenca 4.10 Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21)</i>			
Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se institucioni, vë në dispozicion struktura të posaçme për mbledhjen, përditësimin dhe ruajtjen e të dhënave në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar, diplomuar, transferuar çregjistruar etj. Gjithashtu institucioni ruan të dhëna me të diplomuarit e tij, të cilët shërbejnë dhe si promontor dhe nxitës së punësimit për studentët aktualë. Sekretaria mësimore ruan dhe administron regjistrat e posaçëm dhe gjithashtu ruan të dhëna të format elektronik Megjithatë, <u>GVJ sugjeron</u> që njësia bazë duhet të ketë pjesë të raportit vjetor të veprimtarisë së saj të dhëna mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, të cilat e asistojnë për të marrë masat e duhura për përmirësimin e programit dhe punësimit të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	GVJ vlerëson se institucioni ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve apo përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse apo këshilluese. Referuar Statutit të Universitetit të Tiranës (<i>nenet 30, 40,41,42,43</i>), studentët janë të përfaqësuar në Senatin Akademik si edhe në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës dhe Këshillin e Etikës. Studentët kanë organizimin e tyre të dedikuar, në formën e Këshillit Studentor, si organizime të pavarura, me një mandat 2-vjeçar. <i>Evidenca 1.2.Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 1.23. Rregullore për zgjedhjet e këshillave të studentëve në Universitetin e Tiranës</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ konstaton se garantimi i përfshirjes së studentëve realizohet përmes parashikimit të dedikuar në aktet e brendshme të institucionit. Edhe pjesëmarrja e studentit në procesin e vetëvlerësimit të brendshëm mundëson angazhimin e tyre drejt sigurimit të standardeve të cilësisë. Studentët në mënyrë të tërthortë, përmes shprehjes së mendimit të tyre periodik në pyetësorët e studentëve, përfshihen në vlerësimin e procesit akademik. Studentët janë të organizuar në struktura të pavarura, në formën e Këshillit Studentor. <i>Evidenca 1.2.Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 1.23. Rregullore për zgjedhjet e këshillave të studentëve në Universitetin e Tiranës</i> <i>Evidenca 4.28 Shkresa për ngritjen dhe miratimin e GVB</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e	Në takimin me studentët, GVJ konstatoi se studentët përfshihen në rishikimin dhe përmirësimin e programit të studimit,

studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	nëpërmjet shprehjes së mendimit të tyre, në formularët e vlerësimit të lëndëve apo përmes instrumentave të ndryshëm të ofruar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Gjithashtu, studentët përfaqësues në Senatin Akademik apo në komisionet e përhershme, shprehin dakordësinë e tyre në rastin e miratimit të programeve të reja apo riorganizimit të atyre ekzistuese. Studentët e programit të studimit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e hapura të Departamentit ose shprehin mendimet e tyre përmes Këshillit Studentor. Megjithatë, studentëve nuk u garantohet përfshirja në procesin e hartimit, rishikimit apo përmirësimit të programit të studimit, duke qenë pjesëmarrës në mbledhjet e njësive bazë apo njësive kryesore, Pjesëmarrja në mbledhjet periodike, dhe jo vetëm në vlerësimin përmes pyetësorëve, do të komplomeronte garantimin e përfshirjes së tyre, duke kontribuar konkretisht në përmirësimin e programit të studimit. <i>Evidenca 1.2.Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 1.23. Rregullore për zgjedhjet e këshillave të studentëve në Universitetin e Tiranës</i> <i>Evidenca 2.14.Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave</i> <i>Evidenca 2.17.Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	GVJ vëren se në rregulloret e posaçme, studentëve u mundësohet ankimi i rezultatit dhe rishikimi i tij. Studenti ka të drejtë të njihet paraprakisht me vlerësimin nga ana e komisionit të provimit, përpara se të regjistrohet, rezultati përfundimtar nga sekretaria mësimore. Pas daljes së rezultatit, student që nuk është dakord me vlerësimin, ka të drejtë të bëjë ankesë më shkrim. Referuar rregullores së Fakultetit (neni 46) ankesa i paraqitet drejtuesit të njësisë bazë (brenda 24 orëve), i cili brenda 48 orëve nga depozitimi i ankimit, verifikon dhe bën korrigjimet e duhura. Procedura të tjera janë të parashikuara në rregullore. <i>Evidenca 1.2.Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i>

Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se institucioni, përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse, bazuar në aktet nëligjore të brendshme. Gjtihashtu institucioni merr pjesë vetëm në vlerësimin e programit të studimit, përmes zhvillimit të pyetësorëve vlerësues.</i> <i>Ndërkohë është e nevojshme dhe angazhimi i studentëve në procesin e rishikimit të programit, nëpërmjet pjesëmarrjes periodike në mbledhjet e njësisë bazë apo kryesore, duke shprehur dhe mendimet e konsideratat e grupit të studentëve që përfaqësojnë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përherëshme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ konstaton se institucioni ka njësi e procedura të posaçme në shërbim të informimit të studentëve. Këto procedura dhe njësi përshkruhen në aktet e brendshme të institucionit. Gjtihashtu institucioni harton, miraton dhe publikon udhëzime, procedura dhe broshura informuese. Informimi nuk konsiston vetëm mbi programin e studimit, por dhe informacin lidhur me organizimin dhe funksionimin e institucionit dhe njësisë përbërëse të tij. Informacioni aksesohet online ose përmes zyrave respektive. <i>Evidenca 1.2.Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 1.10. Manual perdorimi i sistemit informatik e-student 2022</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin,	Informimi elektronik realizohet me anë të ngritjes së zyrave të dedikuara të cilat merren me informimin, këshillimin dhe ndjekjen e përparimit të studentëve. Këto struktura mbështeten


këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	edhe nga Këshilli Studentor, i cili mundëson informim dhe mbështetje të vazhdueshme, veçanësisht për studentët e rinj. <i>Evidenca 1.2.Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i> <i>Evidenca 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 1.10. Manual perdorimi i sistemit informatik e-student 2022</i> <i>Evidenca 2.22.Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021</i> <i>Evidencë ekstra Evidence nr. 5. Përditësim i Eëbit FSHS</i> <i>Evidencë ekstra Evidence nr. 9. Plan i punes 2024-2025 Karriera (1)</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Gjatë takimeve në institucion, GVJ konstatoi se Zyra e Këshillimit për Karrierën, ofron mbështetje për studentët për organizimin dhe mbarëvajtjen e këshillimit akademik në funksion të tyre, për të sqaruar çdo paqartësi dhe për trajtuar vështirësitë me të cilat ai haset. Gjithshtu zyra mbështet studentët në vështirësitë akademike dhe kapërcimin e pengesave për arritjen e rezultateve më të mira. Një aspekt shumë i rëndësishëm është edhe këshillimi që u ofrohet studentëve që diplomohen në ciklin e parë, për mundësitë e vijimit të studimeve të ciklit të dytë. Nëpërmjet realizimit të objektivave, mundësohet nxitja e frymës së bashkëpunimit mes institucionit dhe studentëve apo ish studentëve, për të promovuar institucionin dhe praktikën më të mira që ofron. <i>Evidenca 2.22.Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021</i> <i>Evidenca 2.23.Politika për mbështetjen për studentët dhe strukturat e tyre organizative</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Në bashkëpunim me strukturat e këshillimit të karrierës mundësohet sipas GVJ, që të mblidhen, përpunohen dhe të mbahen të dhëna me studentët e diplomuar. Të dhënat e grumbulluara në formën e statistikave u vihen në dispozicion organeve drejtuese përkatëse, për zhvillimin e politikave institucionale dhe për arsye promovimi. <i>Evidenca 2.22.Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021</i> <i>Evidenca 4.11 Të dhëna për diplomimin e studentëve</i>

Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se institucioni, ka procedura dhe njësi të posaçme për pritjen, orientimin dhe këshillimin në karrierë të studentëve. Institucioni mundëson një proces të menaxhimit të ankimeve dhe problematikave të studentëve, duke bashkërenduar procesin mes sekretarisë mësimore të fakultetit dhe dekanit. Procesi i informimit është elektronik por edhe pranë zyrave të posaçme të ngitura e të vëna në dispozicion të studentëve. Institucioni ruan një databazë të studentëve të diplomuar dhe punësuar, duke përpunuar të dhënat e ofruara në kuadër të cilësisë së programit të studimit të ofruar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Gjatë vizitës dhe takimeve në institucion, GVJ vlerëson së institucioni, krijon mundësi për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies. GVJ vlerëson së institucioni ka ngritur Qendrën Virtuale të Trajnimit dhe Zhvillimit Profesional, e cila mundëson në nivel institucioni trajnime edhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies sipas fushës dhe moduleve respektive. Trajnimet mundësojnë përditësimin dhe përqafimin e qasjeve të përditësuara në fushën e inovacionit dhe mësimdhënies.




	Gjithashtu Universiteti i Tiranës, në strategjinë e zhvillimit 2022-2027 synon krijimin e rrugëve për të zbatuar metodat e reja dhe qasjet ndërdisiplinore me mësimdhënien dhe të nxënin. <i>Evidenca 1.20. Vendim SA per ngritjen e qendrës virtuale te trajnimit dhe zhvillimit profesional</i> <i>Evidenca 1.24. Strategjia institucionale per mesimdhënien 2022-2027 vendim-nr.24</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GVJ vlerëson se institucioni ka ngritur një strukturë të dedikuar për zhvillimin e mekanizmave të vlerësimit periodik të aftësive të mësimdhënies. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përmes pyetësorëve periodikë dhe fokus grupeve, analizon strukturën, cilësinë dhe ngritjen akademike të stafit, duke përfshirë të gjithë elementët e procesit mësimor. Në bashkëpunim me strukturat brenda institucionit, njësia propozon dhe ndjek një plan kalendarik të vlerësimit semestral, sipas të cilit monitorohet procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies. <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 1.13. Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së</i> <i>Evidenca 1.11 Manuali i cilesise</i> <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 1.6. Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT</i> <i>Evidenca 2.20. Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik 2020</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Gjatë takimeve në institucion, GVJ konstatoi se institucioni duhet të garantojë përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik, duke i bërë ata pjesë të grupeve të punës për hartimin e pyetësorëve, formave të vlerësimit të dijeve apo përpunimit të të dhënave jo sensitive. Aktualisht studentët janë të përfshirë në procesin e vlerësimit të institucionit, duke qenë pjesë e grupeve të ndryshme të punës, brenda Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, anëtarë të Senatit Akademik, apo komisioneve të tjera në nivel institucioni. Studentët janë të përfshirë në procesin e vetëvlerësimit të programit të studimit, duke dhënë mendimin dhe kontributin e tyre. <i>Evidenca 1.2. Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.3. rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022</i>

	<i>Evidenca 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023</i> <i>Evidenca 1.23. Rregullore për zgjedhjet e këshillave të studentëve në Universitetin e Tiranës</i> <i>Evidenca 4.28 Shkresa për ngritjen dhe miratimin e GVB</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ vëren se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Vlerësimet dhe matja e performancës kryhet në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personeleve respektive. Njohja me raportet e vlerësimit bëhet përmes publikimit por edhe përmes prezantimit të gjetjeve në takime të njësive, me këshillin studentor. <i>Evidenca 1.7. Rregullore për vlerësimin e performancës në punë personeli ndihmes akademik dhe administrative</i> <i>Evidenca 2.17.Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca 2.16.Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023</i> <i>Evidenca ekstra Evidenca nr. 9. Plane pune NJSBC</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ vlerëson se institucioni, përmes mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave më të mira dhe personeli akademik nxitet për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Edhe pse nuk është paraqitur një dokument i posaçëm, kjo rezultoi gjatë takimeve të zhvilluara në institucion, ku personelet pohuan se zhvillohen në mënyrë periodike takime në njësi për analizimin e rezultateve të nxjerra nga vlerësimi. <i>Evidenca 1.7. Rregullore për vlerësimin e performancës në punë personeli ndihmes akademik dhe administrative</i> <i>Evidenca 2.17.Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca 2.16.Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023</i> <i>Evidenca ekstra Evidenca nr. 9. Plane pune NJSBC</i> <i>Evidenca 2.18. Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit.</i>
Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se institucioni, ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo

	realizohet përmes ngritjes dhe funksionimit të një njësie të dedikuar, përgjegjëse për vlerësimin periodik dhe matjes së performancës. Njësia gjeneron formatet e vlerësimit përmes pyetësorëve dhe harton raportet respektive që i vihen në dispozicion strukturave drejtuese dhe personeleve, si pjesë e dosjes së tyre. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë bashkëpunon dhe me njësitë e tjera në institucion për mbarëvajtjen e procesit. Rezultatet bëhen publike si dhe janë objekt diskutimi në mbledhjet e njësive. Duhet të rishikohet roli i studentëve në pjesëmarrjen dhe në proceset e vlerësimit periodik të mësimdhënies dhe matjes së performancës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ vlerëson se institucioni ka politika, struktura dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo politikë reflektohet në aktet e brendshme të institucionit dhe më pas zbërthehet në formën e rregulloreve dhe udhëzimeve respektive, për ti ardhur në ndihmë personeleve dhe studentëve. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Vlerësimet dhe matja e performancës kryhet në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personeleve respektive. Në rastin e personelit akademik me kontratë, vlerësimi i tyre është pjesë e dosjes së personelit pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore. <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i>

	<i>Evidenca 1.13. Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së</i> <i>Evidenca 1.6. Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT</i> <i>Evidenca 1.11 Manuali i cilesise</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca ekstra Evidenca nr. 9. Plane pune NJSBC</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	GVJ konstaton se ngritja dhe funksionimi i Njësishë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është në përputhje me planin strategjik të zhvillimit të institucionit (UT) dhe strategjinë e zhvillimit të programit të studimit Master Profesional Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim. Pjesë e strategjisë së zhvillimit është edhe kontributi aktiv që studentët japin përmes pyetësorëve, duke ofruar mundësitë e evidentimit dhe zhvillimin e mekanizmave vetëpërmirësues të cilësisë. <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 1.11 Manuali i cilesise</i> <i>Evidenca 1.6. Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT</i> <i>Evidenca 1.4. Strategjia-e-Zhvillimit-e-Universitetit-te-Tiranes-2023-2028</i> <i>Evidenca 3.2 strategjia e zhvillimit të Departamentit të Sociologjisë</i> <i>Evidenca 4.2 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	GVJ vlerëson se institucioni ka politika, struktura dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo politikë reflektohet në aktet e brendshme të institucionit dhe më pas zërthehet në formën e rregulloreve dhe udhëzimeve respektive, për ti ardhur në ndihmë personeleve dhe studentëve. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Vlerësimet dhe matja e performancës kryhet në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personeleve respektive. Procesi i vlerësimit të jashtëm kryhet përmes procesit të akreditimit dhe vlerësimit të jashtëm të institucionit dhe programeve të studimit. <i>Evidenca 1.6. Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT</i>

	<i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 1.11 Manuali i cilesise</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca ekstra Evidenca nr. 9. Plane pune NJSBC</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ vlerëson se në institucion përdoren tregues të qartë e të matshëm të mësimdhënies dhe kërkimit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë realizon vlerësimet dhe matjen e performancës, në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personetive respektive. Njësia është përgjegjëse për hartimin e modelit të instrumentave që përdoren. <i>Evidenca 1.6. Rregullore për sigurimin e cilesise ne UT</i> <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 1.11 Manuali i cilesise</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca ekstra Evidenca nr. 9. Plane pune NJSBC</i>			
Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se institucioni, zbaton politika dhe procedura transparente për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Përmes ngritjes së strukturave të dedikuara realizohet mbarëvajtja e procesit, mbledhja, përpunimi dhe analizimi i të dhënave. Institucioni përdor instrumenta dhe tregues për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------




Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ gjatë takimeve të zhvilluar akonstaton se programet e studimit janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm të tyre. Indikatorët për përmirësimin merren nga njohja me rezultatet e vlerësimit, që gjenerohen nga pyetësorët e studentëve. Drejtuesit e njësive marrin pjesë dhe monitorojnë zhvillimin e lëndëve në programin e studimit si dhe ndihmojnë në nxitjen e kërkimit shkencor dhe motivimit për personelet. <i>Evidenca 1.6. Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT</i> <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 1.11 Manuali i cilesise</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca ekstra Evidenca nr. 9. Plane pune NJSBC</i> <i>Evidenca 3.2 strategjia e zhvillimit të Departamentit të Sociologjisë</i> <i>Evidenca 4.2 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit</i> <i>Evidenca 1.13. Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ vëren se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë realizon vlerësimet dhe matjen e performancës, në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personeleve respektive në dosjet e personelit pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore (për personelin me kontrata me afat të caktuar). Informacioni i gjeneruar nga instrumentat e vlerësimit, përdoret në fund të çdo viti akademik nga ana e strukturave përgjegjëse, para firmosjes së kontratave me afat të caktuar <i>Evidenca 1.6. Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT</i> <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 1.11 Manuali i cilesise</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca ekstra Evidenca nr. 9. Plane pune NJSBC</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e	GVJ pas takimeve të zhvilluara në institucion vlerëson së metodat e përdorura në kuadër të vlerësimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit janë gjithpërfshirëse në disa


cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	nivele dhe njësi. Ato mund të organizohen në formën e seancave dëgjimore apo vëzhgimi në një orë mësimi në auditor. Në formën e monitorimit të korigjimit të provimeve, monitorimi i realizuar gjatë hartimit të silabuseve. Ndërkohë paralelisht realizohet përmes instrumentave të pyetësorëve, sondazheve dhe pyetësorëve me fokus grupe. Kjo metodologji lejon gjithpërfshirjen e vlerësimit në disa nivele, duke rritur transparencën dhe mundësuar një vlerësim objektiv. Metodatat e vlerësimit të arritjeve të studentëve janë të përfshira në komponentët e vlerësimit në secilin prej silabuseve të lëndëve. <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca 4.19 Format e kontrollit të njohurive</i> <i>Evidenca mbi Silabuset e lëndëve</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	GVJ vërtet se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë realizon vlerësimet dhe matjen e performancës, në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personeleve respektive. Këto raporte publikohen dhe shpesh janë objekt i mbledhjeve të njësive apo takimeve të tjera të realizuara në institucion, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për sigurimin e standardeve të cilësisë. Gjithashtu studentët kontribojnë jo vetëm në vlerësimin e procesit të mësimdhënies e mësimnxënies, por edhe në vlerësimin e strukturave administrative, shërbimeve dhe kapaciteteve. Praktikë e mirë është edhe përfshirja e studentëve të diplomuar, në vlerësim, përmes pyetësorëve. <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i>



Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se institucioni, monitoron dhe vlerëson përmes njësisë së dedikuar për sigurimin e cilësisë, programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese. Vlerësimi kryhet përmes monitorimit dhe vlerësimit periodik i cili mbidhet përmes instrumentave të pyetësorëve dhe organizimit në fokus grupe. Edhe studentët e diplomuar përfshihen në vlerësimin e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ vlerëson se institucioni parashikon dhe garanton politika e procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në aktet e tij të brendshme rregulluese. Sigurimi i brendshëm i cilësisë garantohej nga njësia përgjegjëse, realizon vlerësimet dhe matjen e performancës, në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave dhe hartimin e raporteve respektive. Pjesë e vlerësimit të jashtëm është procesi periodik i akreditimit dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me ASCAL. <i>Evidenca 1.2.Statuti 2018</i> <i>Evidenca 1.6. Rregullore për sigurimin e cilesise ne UT</i> <i>Evidenca 1.14.Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 1.11Manuali i cilesise</i> <i>Evidenca 2.17.Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca ekstra Evidenca nr. 9. Plane pune NJSBC</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në	GVJ vë re se në rregulloren e NJSBC janë përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, studentët dhe palët e angazhuara në procesin e vlerësimit të brendshëm. Kjo realizohet përmes dinamizmit dhe përfaqësimit të përbërjes së njësisë por edhe

sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	bashkëpunimit që ka me njësitë dhe strukturat e tjera brenda institucionit. <i>Evidenca 1.6. Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	GVJ vëren se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë realizon vlerësimet dhe matjen e performancës, në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave të kategorizuara sipas njësive kryesore dhe njësive bazë. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personeleve respektive për tu njohur dhe për të nxitur politika përmirësuese në të ardhmen. Instrumentat e përdorur nuk fokusohen vetëm në vlerësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies por edhe në vlerësimin e njësive administrative, infrastrukturës, kapaciteteve, mbështetjes etj. <i>Evidenca 1.6. Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT</i> <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 1.11 Manuali i cilesise</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca ekstra Evidenca nr. 9. Plane pune NJSBC</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ vëren se në proceset ciklike të vlerësimit përfshihen dhe aktivizohen personele dhe studentë të cilët respektojnë integritetin akademik. Këto procese përfshijnë qoftë vlerësimin periodik si anëtarë të grupeve të punës ad hoc që ngrihen nga NJSBC por gjithashtu dhe për grupet e punës që ngrihen me synim realizimin e procesit të vetëvlerësimit të programit të studimit. <i>Evidenca 1.6. Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT</i> <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 1.11 Manuali i cilesise</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca ekstra Evidenca nr. 9. Plane pune NJSBC</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen	Gjatë takimeve të zhvilluara në institucion, GVJ konstatoi se bashkëpunëtorët dhe ekspertët e jashtëm, e japin kontributin e tyre në mënyrë aktive apo indirekte, përsa i përket proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Leksionet e



edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	hapura dhe aktivitetet shkencore, janë pjesë e kontributit që jepet në këtë aspekt. Gjithashtu për këtë program studimi janë mundësuar edhe vizita apo shkëmbime me institucionet partnere, duke evidencuar praktikat më të mira. <i>Evidenca 1.25. Plani strategjik i UT për zhvillimin e personelit akademik 2023-2028 VS-6-date-30.01.2023</i> <i>Evidenca 2.16. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023</i>			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se institucioni, përfshin njësitë akademike, personelin akademik dhe studentët në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke kontribuar në këtë formë aktivisht për arritjen e rezultateve më të mira dhe për marrjen e masave në vijim. Vlerësimi kryhet përmes përdorimit të instrumentave të ndryshëm të vlerësimit dhe rezultatet publikon dhe diskutohen.</i> <i>Angazhimi i ekspertëve të jashtëm dhe bashkëpunëtorëve realizohet në formën e leksioneve të hapura ose aktiviteteve të ndryshme shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ vëren se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë realizon vlerësimet dhe matjen e performancës, në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave të kategorizuara sipas njësive kryesore dhe njësive bazë. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personave respektive për tu njohur dhe për të nxitur politika përmirësuese në të ardhmen. <i>Evidenca 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i> <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i>

	<i>Evidenca 1.11 Manuali i cilesise</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca ekstra Evidenca nr. 9. Plane pune NJSBC</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ vlerëson se në rregulloren e NJSBC janë parashikuar mënyrat e publikimit të rezultateve të vlerësimit dhe garantimin e parimit të lirisë dhe etikës akademike. Për zhvillimin e pyetësorëve respektohet parimi i anonimatit dhe rekomandimet dhe sygjërimet e dhëna nuk çënojnë parimin e autonomisë akademike. <i>Evidenca 1.6. Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ gjatë takimeve të zhvilluara në institucion, konstaton se raportet e vlerësimit kanë si synim jo vetëm evidentimin e gjendjes aktuale të cilësisë në institucion, por edhe të mënyrës së ndërhyrjes dhe marrjeve të masave, sipas të dhënave të përpunuara. Edhe pse nuk është paraqitur një dokument për marrjen e një mase konkrete, të dalë nga këto vlerësime, gjatë takimeve në institucion studentët përmendën adresimin e nevojës për të patur sa më shumë orë praktike konkrete të ndërmjetësimit, qoftë edhe në formën e aktiviteteve jashtëkurrikulare.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ vëren se institucioni përmes NJSBC realizon vlerësimet dhe matjen e performancës, në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personave respektive. Këto raporte publikohen dhe shpesh janë objekt i mbledhjeve të njësive apo takimeve të tjera të realizuara në institucion, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për sigurimin e standardeve të cilësisë. Gjithashtu studentët kontribuojnë jo vetëm në vlerësimin e procesit të mësimdhënies e mësimnxënies, por edhe në vlerësimin e strukturave administrative, shërbimeve dhe kapaciteteve. <i>Evidenca 1.6. Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT</i> <i>Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Evidenca 1.11 Manuali i cilesise</i> <i>Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024</i> <i>Evidenca ekstra Evidenca nr. 9. Plane pune NJSBC</i>

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se institucioni garanton veprimtari periodike me personelin dhe studentët, me synim jo vetëm informimin për organizimin dhe funksionimin e institucionit në të gjitha njësitet përbërëse të tij, por dhe synon rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në institucion. Për këtë arsye në mënyrë periodike organizohen aktivitete trajnuese dhe ndërgjegjësuere, gjithpërfshirëse, ku tematikat e trajnimit herë lidhen në mënyrë direkte e herë në mënyrë jo direkte me sigurimin e cilësisë së programeve të studimit dhe sigurimin e cilësisë në institucion.			
Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se institucioni, politikat, proceset dhe veprimtaritë për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë publike transparente dhe efektive. Politikat zërthehen në aktet e brendshme të institucionit por edhe në strategjinë apo planin e zhvillimit të tij. Për çdo raport vlerësimi, sipas gjetjeve respektive duhet të publikohet edhe plani i masave të nevojshme për tu ndërmarrë. Institucioni organizon veprimtari trajnuese dhe ndërgjegjësuere për rëndësinë dhe efikasitetin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në
“Zgjidhje e Konfliktëve me Ndërmjetësim”**

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Qëndrueshmëria dhe kualifikimi i personelit akademik
2. Kurrikula e mirëorganizuar dhe multidisiplinare
3. Bashkëpunimi me institucione dhe organizma me objekt ndërmjetësimin

b. Pika të dobëta

1. Literatura e pamjaftueshme për tju përgjigjur dinamikave të zhvillimit të ndërmjetësimin (Standartdi IV.3, Kriteri 2)
2. Përfshirja dhe organizimet e pakëta e studentëve ALUMNI (Standarti II.5, Kriteri 3)

Rekomandime

1. Rishikimi dhe pasurimi i literaturës
2. Rishikimi i politikave të promovimit të programit të studimit dhe përfshirja e studentëve ALUMNI
3. Rritja e kapaciteteve dërguese dhe ftuese të shkëmbit të studentëve dhe personelit në kuadër të programit ERASMUS+

**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master in
"Conflict Resolution through Mediation"**

a. Strengths and affirmations

1. Sustainability and qualifications of academic staff
2. Well-organized and multidisciplinary curriculum
3. Cooperation with institutions and organizations with the aim of mediating

b. Weaknesses

1. Insufficient literature to respond to the development dynamics of mediation (Standartd IV.3, Criterion 2)
2. Involvement and few organizations of ALUMNI students (Standarti II.5, Criterion 3)

Recommendation

1. Review and enrichment of literature
2. Review of study program promotion policies and involvement of ALUMNI students
3. Increase the sending and inviting capacities of the students and staff within the framework of the ERASMUS+ program

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X